**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "INFORMATIKË EKONOMIKE"**

**ofruar nga**

**Kolegji Universitar "Reald"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**
**Prof.As.Dr Etleva Leskaj**
**Dr. Alketa Grepcka**

**Prill / 2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Për Programin e studimit Bachelor në "Informatike Ekonomike"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Universitar "REALD" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Financës (Fakulteti i Ekonomisë) |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Informatike Ekonomike" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMAS nr. 387, datë 08.07.2022 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | Akreditim për herë të parë |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike/6 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 Kredite (ECTS) |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli i 6 (gjashtë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2022 - 2023: 5 PAE / 3 PAK<br>2023 - 2024: 7 PAE / 1 PAK<br>2024 - 2025: 8 PAE / 2 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2022 - 2023; 7 studentë<br>2023 - 2024; 12 studentë<br>2024 - 2025; 21 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatike Ekonomike" ka filluar të zhvillohet në vitin akademik 2022-2023 dhe në vazhdim. Ai është licensuar me UMAS nr. 387, datë 08.07.2022. Programi zhvillohet nga Departamenti i Financës, të Fakultetit të Ekonomisë, pranë Kolegjit Universitar "Reald". Objektivi kryesor i programit Bachelor në "Informatike Ekonomike" është përgatitja e specialistëve të lartë që t'i përgjigjen kërkesave të kohës, nevojave të tregut rajonal, kombëtar dhe atij ndërkombëtar të punës, për përballimin e kërkesave të një ekonomie gjithmonë në progres.

Tërësia e njohurive, që marrin studentët, ndikon në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e shkencave të informatikës dhe te ekonomise, me objektiv dhënien e njohurive bazuar në arritjet më të fundit bashkëkohore në fushën e informatikës ekonomike dhe përvojat shumëvjeçare të studimit të këtyre aspekteve në realitetin shqiptar. Programi synon të përgatisë studentët me konceptet bazë mbi rolet dhe funksionet e një informaticieni të njësie ekonomike, etj. Gjithashtu, ky program synon të përgatisë specialistë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fushën e informatikës ekonomike. Në përfundim të programit studenti aftësohet për t'u punësuar në njësitë e ndryshme ekonomike dhe sektorët që lidhen me funksionet bazë të informaticienit ne njesite ekonomike. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat, që marrin studentët nëpërmjet harmonizimit të njohurive me bazë teorike, të fushës dhe ato ndihmëse e duke vijuar me thellime në fushën e informatikës ekonomike etj., krijojnë bazën për një karriere kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Mundësitë për punësim realizohen nga nevojat e tregut për informaticiene ne fushën e ekonomise.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës

së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë ta paraqesin sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

¬ Standardet nuk përmbushen;

¬ Standardet përmbushen pjesërisht;

¬ Standardet përmbushen kryesisht;

¬ Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Prof.As.Dr. Etleva Leskaj** dhe **Dr. Alketa Grepcka.** Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL MSc. Arbri Ndreka.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vleresimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Kolegjin Universitar REALD që u zhvillua në datën 5-6 Dhjetor 2024 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimt të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë mbi programin e studimit që akreditohet, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të studentëve të diplomuar. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra me programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" duke dhënë disa sugjerime/rekomandime.

Kolegji Universitar REALD, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.03.2025, pëmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.13/7 Prot, datë 20.03.2025. IAL njofton në ASCAL më datë 25.03.2025, me anë të shkresës me Nr. 13/8 Prot, datë 27.03.2025 "Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm dhe nuk kanë komente. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Informatikë Eknomike"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<table>
<tr><th colspan="2">Standardi I.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</td><td>Kolegji Universitar "Reald" (KUR) është i regjistruar si person juridik privat I njohur nga Legjislacioni Civil dhe Tregtar Shqiptar, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 29.05.2009, me NIPT K86607207N dhe vepron si Institucion Jopublik i Arsimit të Lartë me karakter akademik dhe shkencor.<br>Neni 4 në Statut thekson: "..Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si edhe në forcimin e sigurisë publikë dhe kombëtare" dhe programet e ofruara nga ky institucion nuk bien ndesh me interesat kombetare, madje në të kundër kontribuojnë në zonën rajonale të Vlorës dhe të vendit në përgjithësi përmes sigurimit të një brezi studentësh të kualifikuar<br>Ref. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</td><td>KUR zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me qëllimin, vizionin dhe misionin e tij të cilat shprehen qartë në nenin 4 në Statut . KUR në veprimtarinë e tij ka për qëllim të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor . Në misionin e tij ai përfshin:<br>• Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushën e shkencave Ekonomike dhe Mjekësore;<br>• Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;<br>• Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të Financës, Menaxhimit, Infermierisë, Fizioterapisë, Farmacisë dhe Stomatologjisë;<br>• Thellimin e kualifikimit professional e shkencor të specialistit të lartë në fushën Master Profesional në Menaxhim Infermieror;<br>• Kryerjen e studimeve kërkimore shkencore në përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit;<br>• Të ofrojë mundësi më të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;<br>Veprimtaria akademike e KUR zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës [Ref. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD]. GVJ konstaton se programi I studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është hartuar në</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | përputhje me misionin e institucionit dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij<br>*Ref. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD*<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024; 14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike.*<br>*Ref. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, neni 4.1*<br>*Ref. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, neni 4.2.* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | KUR zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në një strategji zhvillimi të mirëpërcaktuar . Programi I studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" Zhvillohet në perputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit. Synimet kryesore të Strategjisë së Zhvillimit të KUR 2021-2026 janë pjesë përbërëse e synimeve të këtij program studimi. GVJ konstaton prioritetet kryesore si vijon më poshtë:<br>1. *Forcimin e lidhje me kompanitë e biznesit dhe studimin e tregut të punës;*<br>2. *Forcimin institucional përmes zhvillimit të strukturave në shëbim të procesit mësimor;*<br>3. *Zhvillimin e mësimdhënies, kurrikulave dhe mësimnxënies duke vendosur në qendër studentin;*<br>4. *Forcimin e bashkepunimit me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit;*<br>5. *Rritjen e kualifikimit të stafit akademik;*<br>6. *Përmirësimit të infrastrukturës mësimore;*<br><br>GVJ nga takimet e zhvilluara në institucion dhe bazuar në evidencat e paraqitura dhe përmbajtja e tyre konstaton se programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofrohet në përputhje me dokumentat bazë: Statut të KUR, Rregullore Institucionale, Rregullore të Fakultetit të Ekonomisë dhe zhvillon veprimtarinë e tij bazuar edhe në Rregulloren e Programit të Studimit Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" zhvillohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe GVJ gjen përputhje të tij me drejtimet akademike të njësisë kryesore ku ofrohet ky program studimi<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*5. Rregullore e njesise kryesore FE*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike*<br>*Ref. 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 – 2026* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | KUR zotëron kapacitete dhe burime të duhura për të mundësuar zhvillimin e programit mësimor Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Ky program zhvillohet në Fakultetin e Ekonomisë (FE) i cili përbëhet nga dy njësi bazë dhe 1 Qendër Kërkimore si vijon më poshtë:<br>1. Departamenti i Financës;<br>2. Departamenti i Menaxhimit;<br>3. Qendra Kërkimore; |

| | |
|---|---|
| | Programi I studimit Bachelor në "Informatikë Eonomike" zhvillohet në departamentin e Financës. Të dhënat statistikore shprehin një qëndrueshmëri të stafit akademik në nivel Fakulteti dhe në nivel departamenti. Tabela më poshtë jep një pasqyrë të numrit total të stafit akademik në vitë të FE-së. |

| KUR | Fakulteti I Ekonomisë | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri PAE | Numri PAK | Numri P ndihmes akademik | Total |
| | Gj | Gj | Gj | |
| 2023-2024 | 21 | 5 | 0 | 26 |
| 2022-2023 | 21 | 3 | 0 | 24 |
| 2021-2022 | 21 | 1 | 0 | 22 |

| KUR | Departamenti i Financës | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri PAE | Numri PAK | Numri P ndihmes akademik | Total |
| | Gj | Gj | Gj | |
| 2023-2024 | 7 | 3 | 0 | 10 |
| 2022-2023 | 7 | 2 | 0 | 9 |
| 2021-2022 | 7 | 1 | 0 | 8 |

*GVJ konstaton se në mbështetje të programit të studimit nuk angazhohet personel ndihmës akademik dhe për këtë rekomandon vendosjen e tyre në organikë.* Institucioni ofron një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e programit mësimor me nje bazë të gjerë laboratorike

*91. Të dhëna për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit ne dy vitet e fundit; 102. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - Informatike Ekonomike*

*100. Lista e aseteve te luajtshme ne IAL; 101. Lista e aseteve te luajtshme ne IAL*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të | Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Ekonomisë (FE) në Departamentin e Financës (DF). Fusha e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë. Bazuar edhe në evidencat e paraqitura Fakulteti i Ekonomisë ofron në total 5 programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë. |

| KUR | | Viti akademik 2023-2024 |
|---|---|---|

programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

| | Nr. Prof. profesional dhe jouniversitare | Nr. prog. BSc. | Nr. prog. MSc. | Nr. Prog. MP | Nr. Prog. Master I Integruar | Nr. Prog. Dr. | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Departamenti I Financës | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | **3** |
| Departamenti I Menaxhimit | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | **2** |
| Qendra Kerkimore | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| **Total** | **1** | **3** | **1** | **0** | **0** | **0** | **5** |

| | |
|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se KUR është një institucion jopublik I arsimit të lartë I cili ofron programe studimi në pëpruthje me misionin dhe objektivat strategjikë të tij. Programi I studimt ofrohet në Fakultetin e Ekonomisë në Departamentin e Financës në akordancë më drejtimet akademikë të percaktuar në Statut dhe në Rregullore Institucionale. Evidencat e paraqitura tregojnë një qëndrueshmëri të statit akademik për periudhen 2021-2024 ndonëse numri I stafit akadmeik me grada shkencore është shumë i ulët. GVJ evidenton mungesën në organikë të stafit ndihmës dhe rekomandon përmbushjen e ketij kriteri.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe | KUR mbështet veprimtarinë e tij në kuadrin ligjor dhe vecanërisht në ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shiperisë" dhe zbaton kornizën ligjore të shprehur në Statut dhe në rregulloret institucionalë të aprovuara nga Senati Akademik Kreu II në Statut përcakton strukturën akademike të KUR të cilën GVJ e gjen në përputhje edhe më organigramën e institucionit e vendosur në aneks të tij. Detyrat dhe përgjegjësitë janë dhënë qartë Statut në Sesionin II, kapitulli "Rektorati I Kolegjit", sesioni III "Dekanati I Kolegjit", sesioni IV "Asambleja e |

| | |
|---|---|
| analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Personelit Akademik të Njësisë Kryesore", sesioni IX dhe X përkatësisht "Rektori" dhe "Dekani i Fakultetit në KUR". GVJ u njoh edhe me Rregulloren e KUR miratuar me vendimin nr.33 datë 22.04.2020 të ndryshuar e cila përshkruan qartë strukturën organizative të KUR (kreu II), funksionet dhe kompetencat e organeve dhe autoriteteve drejtuese (kreu III) dhe organizimin e studimeve universitare në KUR (kreu V) .<br>Specifikat në lidhje me lëndët, ngarkesën mësimore dhe detyrimet e studentëve janë dhëne qartë në Rregulloren e Programit të Studimit. . Në këtë kontekst GVJ gjen një kuadër ligjor që buron nga niveli i vendimarrjes deri në nivelin e programit të studimit të institucionalizuar ku secila hallke ka të percaktuar qartë rolin e saj. Për sigurimin e veprimtarisë mësimore Departamenti i Financës bashkëpunon me Departamentin e Menahimit dhe Qendrën Kërkimore dhe stafin PAK të angazhuar në këtë program studimi . Njësia bazë analizon veprimtarinë vjetore të procesit mësimor dhe të përsonelit akademik dhe harton raporte. GVJ u njoh me raport për vitin akademik 2023-2024 dhe vëren qe shumë elemente të procesit mësimor mungojnë në këtë analizë. *GVJ rekomandon që Departameni i Financës duhet të trajtojë edhe problematikat në lidhje me procesin mësimor, rezultatet e studentëvë, rezultatet nga anketimet e studentëve dhe shumë element të veprimtarisë së stafi akademik në drejtim të pjesëmarrjes së tyre në konferenca apo aktivitete të tjera brenda dhe jashtë vendit*<br><br>*5. Rregullore e njesise kryesore FE;*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike*<br>*2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, neni 7*<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*31. Analize e njesise baze per arritjen e objektivave te programit* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Për realizimin e programit të studimit KUR dhe Departamenti i Financës konsiderojnë të rëndësishme bashkëpunimin me të gjithë hallkat brenda dhe jashtë institucionit. Nga zhvillimi i këtyre veprimtarive bashkëpunuese vlen të përmenden në nivel institucional:<br>a. **Bashkëpunime me universitete brenda vendit**- GVJ u njoh me marrëveshje të nënshkruar me Kolegjin Universitar të Biznesit, Universitetin e Vlorës<br>b. **Marrëveshje me Institucione Shtetërore**- Në katë kuadër është nënshkruar marrëveshje me Akademinë e Shkencave, Kuvendin e Shqipërisë<br>c. **Marrëveshje me universitetin e Salernos**<br><br>*GVJ konstaton se bashkëpunimet me universite brenda vendit dhe sidomos me rrethin e Tiranës janë të pakta. Duke konsideruar statusin e të qënurit Kolegj Universitar mbështetja dhe marrja e përvojës nga* |

| | |
|---|---|
| | ***universitetet është një domosdoshmëri sidomos në drejtim të zhvillimit të përsonelit akademik.***<br>*80. Mareveshje bashkepunimi Kolegji Universitar i Biznesit;*<br>*84. Marrëveshja me Universitetin e Vlores dhe Aneksi 1. i Marreveshjes*<br>*82. Marreveshja me Akademine e Shkencave - e firmosur;*<br>*83. Marreveshje Bashkpunimi me Kuvendin e Shqiperise*<br>*81. Marrëveshje me Universitetin e Salernos 2022* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Zhvillimi i praktikës profesionale është i përfshirë në programin mësimor të programit të studimit Bachelor "Informatikw Ekonomike" vlerësuar në total me 6 ECTS dhe planifikuar të zhvillohet në semestrin e dytë tw vitit tw tretw Për zhvillimin e praktikws profesionale Departamenti i Financës i kushton vëmendje bashkëpunimit me kompanitë e biznesit dhe institucionet shtetërore rajonale. Për vitin 2023-2024 janë nënshkruar 17 marrëveshje kryesisht më hotelerite në rrethin e Vlorës, bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Vlore, Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore, NBG Bank, Këshilli i Qarkut Vlorë etj Bazuar në raportin vjetor dhe në takimin me studentët dhe stafin akadmeik konstatojmë një gadishmëri të institucioneve në pritje të studentëvë që zhvillojnë praktikën, vënien në dispozicion të dokumentacionin dhe shprehjen e interest për punësim të studentëvë në përfundim të studimeve. Bazuar në anketimet e kryera studentët kanë shprehur mendime pozitive në lidhje me zhvillimin e tyre në kompanitë me te cilat janë nënshkruar marrëveshje dhe ecuria e tyrë është monitoruar edhe nga pedagogu udhëheqës i cili ka raportuar në department në mënyrë periodike në lidhje me problematikat e dala<br>*14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike.*<br>*31. Analize e njesise baze per arritjen e objektivave te programit*<br>*takim me stafin akademik; takim me studentët* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Njesia bazë përmes monitorimit të praktikës mësimore në institucionet host ku studentët kryejnë këtë veprimtari analizon në fund të vitit edhe përftimet përmes këtyre bashkepunimeve të cilat reflektohen edhe në raportin vjetor që njësia bazë harton ne fund të vitit akademik<br>*GVJ propozon qe analiza në lidhje me bashkëpunimet në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale duhet të shprehë edhe problematikat e dala dhe plan veprimin në lidhje me përmirësimin e tyre.*<br>*31. Analize e njesise baze per arritjen e objektivave te programit* |
| **Konkluzione** | *KUR ka të ngritur struktura të cilat zhvillojnë veprimtarinë ë tyre në përputhje me Statut dhe Rregulloren Institucionale.. KUR zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në Strategjinë e Zhvillimit dhe në fokus ka forcimin e bashkëpunimit me universitete partnere brenda dhe jashte vendit.GVJ konsideron që numri i bashkëpunimeve është i pakët dhe propozon rritje të tyre në vitet e ardhshme. FE dhe Departamenti i Financës i kushtojnë një vëmendje bashkepunimit me kompanitë e* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *biznesit në drejtim të forcimit të procesit të praktikës profesionale. Raporte në këtë drejtim hartohen nga njësia bazë por propozojmë që më shumë analizë duhet të bëhët në drejtim të pasqyrimit të problematikave, trajtimit të tyre dhe marrjes së një plan masash për përmirësim.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga institucioni GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" eshte ndertuar në perputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".<br>Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total ka 180 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 33 (31 lëndë, 1 Praktikë profesionale dhe Diplomimi). Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe . Programi i studimit në nenin 5 dhe 6 të tij përcaktojnë format e studimit, provimeve, verifikimeve të dijeve të fituara, ndërsa programi mësimor jep informacion të detajuar në lidhje me objektivatd dhe veprimtaritë formuese të tij .Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është program studimi që i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, kodi i programit është 63BA06885 dhe dhe mbulohet nga Departamenti i Financës Ky program përmban elementet e nevojshem (modulet, lëndët dhe kreditet përkatëse për secilin prej tyre, shpërndarjen në çdo semestër), kushtet e pranimit dhe përzgjedhjes, metodat e vlerësimit të studentëve dhe progresi i tyre, kushtet për transferim dhe çdo element detyrues në përputhje me kuadrin ligjor dhe specifikisht me VKM Nr.41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe dispozitat e dhëna në Rregulloren e KUR<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024* |

| | |
|---|---|
| | *6. Rregullore e Programit  Bachelor në Informatikë Ekonomike;*<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar;* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është ndërtuar në perputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Objektivi kryesor i programit të studimit "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" është t'u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, etj., me objektiv kryesor formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon studime në fusha të tilla bazë si gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterëve, sistemet e operimit, algoritmikë, strukturë të dhënash, etj., të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë e zbatuar në ekonomi, mikroekonomi, makroekonomi, etj. Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.<br>**Objektivat specifikë të programit të studimit përfshijnë:**<br>• Përgatitjen e studentëve në fushat bazë të informatikës teorike dhe të aplikuar duke siguruar progres të mëtejshëm në studimet e tyre.<br>• Përgatitjen profesionale të studentëve në aplikimin e njohurive të informatikës në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë në përshtatje të vazhdueshme me tregun e punës.<br>• Aftësimin e studentëve për të analizuar dhe dizenjuar sisteme informatike në funksion të fushave të ndryshme të shoqërisë.<br>• Studentët të fitojnë njohuri bazë dhe të thelluara për një klasë të gjerë të teknikave të zgjidhjes së problemave reale informatike.<br>• Studentët të fitojnë njohuritë bazë në shkencat kompjuterike rreth gjuhëve të programimit, sistemeve informatike, sistemeve të operimit, bazave të të dhënave etj.<br>• Studentët të fitojnë aftësi për të punuar në një ambient multidisiplinar.<br>• Studentët të fitojnë aftësi për të komunikuar qartësisht me shkrim apo nëpërmjet prezantimeve koncepte teknike.<br>• Studentët që përfundojnë programet e studimit të jenë të aftë të analizojnë, projektojnë, implementojnë një zgjidhje softuerike e orientuar nga objektet për probleme reale.<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ | Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike ë" përmban lëndë dhe module të trajtuara gjerësisht në aspektin teorik dhe praktik. GVJ gjen në këtë program studimi një set lëndë dhe module të cilat formojnë një bazë të gjerë njohurish për studentin dhe marrjen e koncepteve bazë themelore në këtë fushë.<br>• Disiplina " Lëndë Bazë (A) – Përmban 7 lëndë të formimit të përgjithshmëm; |

modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

- Disiplina "Lënde Karakterizuese (B) përmban 17 lëndë duke i ofruar studentit një formim të gjerë teorik dhe praktik në fushën e programimit dhe ekonomisë. Përmendim këtu lëndë që japin formim në drejtime:

a. Informatike: Hyrje në Informatikë, Algoritmikë, Programin në JAVA, Multimedia, Struktura e të Dhënave, Arkitekturë Kompjuteri, Programim në C++, Sistemet e Shfrytëzimit, Komunikim të Dhënash dhe Rrjeta Kompjuterike, Ssguria e SisteMeve Kompjuterike, Programim në WEB, Teoria e Bazave të të Dhënave;,

b. Ekonomi: Statistikë, Sistemet e Informacionit dhe Menaxhimit, Ekonometri;

të cilat janë disa prej lëndëve në këto disiplina të cilat kontribuojnë në një formim të përgjithshëm dhe karakterizues teorik dhe praktik me profilizim ne Informatikë.

- Disiplina "Lëndë ndërdisiplinore integruese" (C ) përmban 5 lëndë ku 3 janë në fushën e ekonomisë (Marketing dhe Menaxhim, Inovacion/Etike Biznesi), 1 Lëndë në fushën e Informatikës (Projektim Software/ Softwëare aplikativë/ Siguria e Informacionit/ Grafikë Inxhinierike) të cilat janë lëndë me zgjedhje dhe merren nga studenti në vitin e tretë, semestri i parë dhe vlerësohen me 5 ECTS.
- Disiplina "Lëndë plotësuese" (D) ofron ofron lëndë gjuhë e huaj (anglisht/italisht) dhe praktikën profesionale.
- Disiplina "Detyrimet përmbyllëse" (E) ofron edhe punimin e diplomës ose provim formimi Bachelor me 6 ECTS.

| Kategoria | Tipi | ECTS | % | Standardi |
|---|---|---|---|---|
| A | Lëndë Bazë | 36 | 20% | 15-20 % |
| B | Lëndë karakterizuese | 98 | 54.44 % | 50-55 % |
| C | Lëndë ndërdisiplinore / integruese | 22 | 12.22 % | 12-15 % |
| D | Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale | 18 | 10% | 10-15 % |
| E | Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar | 6 | 3.33% | 3-5 % |

Nga analiza e programit të studimit, GVJ konstatoi se janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore. Duke i ballafaquar dhe përshtatur në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

GVJ në lidhje me këtë element të programit të studimit jep konsiderat si vijon më poshtë:

- Ndarja e lëndëve sipas kategorive është në përputhje me standartet e kërkuara për secilën discipline;

| | |
|---|---|
| | • Bazuar edhe në VKM nr.41 date 24.01.2018 për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" përqindja totale e lëndeve të kategorise "A" + "B" është 74.44% duke tejkaluar në në një masë shumë të vogël (4.44%) kërkesën e përcaktuar në kornizën ligjore por pa cënuar dhe rënduar ngarkesën e programit mësimor;<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024;*<br>*14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përmban praktikën mësimore e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë e vendosur në disiplinën "Lëndë plotësuese" (D), me kod të lëndës PRA 313. Ngarkesa totale është 6 ECTS e konvertuar është 200 orë. *GVJ propozon që ngarkesa totale e praktikës mësimore duhet të rregullohet në planin mësimor sepse jepet 70 orë në auditor dhe 80 orë në laborator dhe në total jepet 200 orë. Nga takimet e zhvilluara u theksua zhvillimi i praktikës profesionale më një ngarkesë në total 200 orë, dhe për këtë propozojmë të bëhët rregullimi I duhur në planin mësimor për këtë program studimi.*<br><br>Studentët ë kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale dhe kjo shprehet qartw nw Rregulloren e Institucionit . Njësia bazë është përgjegjëse për zhvillimin e saj. Nga takimet e zhvilluara në institucion u theksua njoftimi që bëhët tek studentëtë në fillim të vitit të tretë për kryerjen e praktikës profesionale, mënyrën e zhvillimit dhe mënyrën e shlyerjes së saj. Praktika profesionale zhvillohet në kompanitë për të cilat njësia bazë dhe Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe evidencat në raportet vjetore tregon përpjekje të departamentit në lidhje me rritjen e numrit të bashkëpunimeve<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike;*<br>*27. Disa nga marreveshjet e bashkepunimit aktive me aktoret e biznesit per kryerjen e praktikes mesimore* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Forma e studimeve të programit të studimeve të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" është me kohë të plotë. Programi përbehet nga lëndë të organizuara në module, duke përfshirë praktikën profesionale. Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, projektet dhe detyra, praktikat, seminare dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor dhe tw shprehur nw detaje nw syllabuset e programeve lwndore Rregullorja Institucionale përcakton qartë në Kreun V organizimin e studimeve dhe GVJ gjen procesin mësimor në përputhje edhe me rregulloren e programit të studimit përkatësisht me nenin 6 të tij<br>Institucioni përcakton qartë kushtet dhe kriteret e pranimit. Neni 38 në Rregulloren e IAL përcakton se pranimi I studentëvë bëhët në përputhje me kriteret e pranimit të miratuar nga Senati Akademik. Neni 8 në rregulloren e programit të studimit përcakton kushtet e domosdoshme për aplikim në programin e ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" . Studentët, të cilët zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e Maturës Shtetërore, ata |

persona që zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, ose ata që zotërojnë një diplomë të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë kanë mundësinë të aplikojnë për t'u pranuar në programin e studimeve të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" që ofron KUR. Përzgjedhja e studentëve bëhet nga nje komision i caktuar nga Fakulteti i Ekonomisë. Kryetari I komisionit dhe anëtarët përcaktohen nga dekani i fakultetit. Metoda e përzgjedhjes konsiston në përzgjedhjen e studentëve nëpërmjet konkurrimit të dosjeve.
Kriteret e vlerësimit vendosen nga Senati Akademik dhe publikohen. Kanë përparësi në vlerësim:
- Mesatarja e notave të shkollës së mesme;
- Referenca e kandidatit për student.

Si fushë paraardhëse të studimit është:

- Shkolla e mesme e përgjithshme;
- Shkolla e mesme profesionale në fushën e informatikës, ekonomisë dhe elektronikës;

Numri maksimal i studenteve në programin e studimeve të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" është 100 (njëqind). KUR ndërmerr edhe politika të mbështetjes financiare për kategoritë:

- Bursa për studentët ekselentë me mesatare mbi 9.5 (50% mbështetje);
- Bursa për kategoritë në nevojë (50% mbështetje);
- Bursa për studentët me aftësi të kufizuara (50% mbështetje);

KUR ofron edhe uota të dedikuara për student të kategorive të vecanta si persona me aftësi të kufizuar dhe studentë të komunitetit rome dhe egjiptian
KUR ka të përcaktuar qartë edhe dispozitat në lidhje me transferimin e studentëve. Neni 12 në Rregulloren e KUR thekson se pranohen transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga institucionet e tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja, publike ose private dhe lejon transferimin e studentëve të saj në institucione të tjera të arsimit të lartë, sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore. Studenti që transferohet nga një institucion i arsimit të lartë në KUR paraqet një kërkesë rektoratit ku të parashtroje arsyet e transferimit. Së bashku me kërkesën duhet të paraqes një kopje të diplomës së shkollës se mesme (të noterizuar), detyrimet e shlyera në shkollën dërguese me notat përkatëse, një kopje të programeve të disiplinave të shlyera dhe një dokument identifikimi

| Titulli I programit | Sipas viteve akademike | Të regjistruar për herë të parë | Nota mesatare në hyrje | Studentë të transferuar sipas viteve | | | Studentë të transferuar për ... | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Viti I | Viti II | Viti III | | |
| BSc "Informatike Ekonomike" | 2022-2023 | 7 | 7.3 | - | - | - | - | 7 |
| | 2023-2024 | 8 | 7.8 | - | 5 | - | - | 13 |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | KUR nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtesë por përmbajtja e tij është më programe që ofrohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Universiteti i Salernos, Itali<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024; 18. Syllabuset - Viti I;*<br>*18. Syllabuset - Viti II; 18. Syllabuset - Viti III*<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar.;*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike;*<br>*30. Të dhënat mbi kriteret e pranimit në programin e studimit tarifa dhe modalitetet finaciare për studentët*<br>*takim në institucion* |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | GVJ konstaton se programi istudimit të ciklit të parë "Informatikë Ekonomike" ka kodin 63BA0688S<br>*76. Tabela e kodifikimit te programeve te studimit në KUR* |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | **Jo e aplikueshme** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi I studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është I hartuar në përputhje me dispozita ligjore. Programi përmban ngarkesën në auditor dhe jashtë tij të shpërndarë në tre vitet akademike. Forma e organizimit dhe kriteret e pranimit dhe të transferimit janë në përPuthje me Rregulloren e Përgjithshme të KUR, Rregulloren e programit të studimit.* GVJ konstaton se programi istudimit të ciklit të parë "Informatikë Ekonomike" ka kodin 63BA0688S |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet Kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2** |
|---|

<table>
<tr><th colspan="2">Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</td>
<td>Fakulteti I Ekonomisë ku zhvillohet edhe programi I studimit në ciklin e parë "Informatikë Ekonomike" përmbush detyrimet ligjore, referuar Kreut V të Ligjit për Arsimin e Lartë nr.80/2015 për "Organizimin akademik dhe administrative i IAL".<br>Referuar Rregullores së këtij njësie Kreu II përcakton qartë strukturën organizative e cila është në linjë edhe me Rregulloren e institucionit FE përbëhët nga Dekanati, departamentet dhe Këshilli I Fakultetit (neni 3). Nenet në vijim përcaktojnë detyrat për autoritet drejtuese përkatësisht : Neni 6 : Autoritet drejtuese; Neni 7: Zv. Dekani I Fakultetit; Neni 8: Përgjegjësi I departamentit;<br>Organizimi i strukturës akademike të FE-së është në përputhje të plote edhe me Statutin e KUR përkatesisht Kreu III i tij (Struktura organizative e Kolegjit Universitar "Reald") Fakulteti i Ekonomisë në KUR përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik duke përmbushur kriterin ligjor për numrin minial 7 të stafit akademik, ndonëse GVJ konstaton se numri I personelit me grada shkencore është I ulët.<br><br>FE i përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:
<table>
<tr><th rowspan="3">KUR</th><th colspan="6">Fakulteti i Ekonomisë (2023-2024)</th></tr>
<tr><th colspan="2">Numri PAE</th><th colspan="2">Numri PAK</th><th>Numri P ndihmes akademik</th><th rowspan="2">Total</th></tr>
<tr><th>Gj</th><th>Tituj, Grada</th><th>Gj</th><th>Tituj, Grada</th><th>Gj</th></tr>
<tr><td rowspan="5">Departamenti i Financës</td><td rowspan="5">7</td><td>(0) Prof. Dr.</td><td rowspan="5">4</td><td>(0) Prof. Dr.</td><td rowspan="5">0</td><td rowspan="5">11</td></tr>
<tr><td>(1) Prof. Asoc.</td><td>(1) prof. Asoc. Dr.</td></tr>
<tr><td>(2) Dr.</td><td>(2) Dr.</td></tr>
<tr><td>(0)Dr. proc.</td><td>(0) Dr. proces</td></tr>
<tr><td>(5) Msc</td><td>(1) Msc.</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Departamenti i Menaxhimit</td><td rowspan="3">7</td><td>(1) Prof. Dr.</td><td rowspan="3">1</td><td>(0) Prof. Dr.</td><td rowspan="3">0</td><td rowspan="3">8</td></tr>
<tr><td>(1) Prof. Asoc.</td><td>(0) Prof. Asoc. Dr.</td></tr>
<tr><td>(1) Dr.</td><td>(0) Dr.</td></tr>
</table>
</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | (0)Dr. proc. | | (0) Dr. proces | | |
| | | (4) Msc | | (1) Msc. | | |
| Qendra Kërkimore | 7 | (0) Prof. Dr. | 0 | (0) Prof. Dr. | 0 | 7 |
| | | (0) Prof. Asoc. | | (0) prof. Asoc. Dr. | | |
| | | (5) Dr. | | (0) Dr. | | |
| | | (0)Dr. proc. | | (0) Dr. proces | | |
| | | (2) Msc | | (0) Msc. | | |
| **Total** | **21** | | **5** | | **0** | **26** |

| **Departamenti I Financës** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| TOTAL (2023-2024) | 7 | (0) Prof. Dr. | 4 | (0) Prof. Dr. | 0 (P. ndihmes akademik) | 11 |
| | | (1) Prof. Asoc. | | (1) Prof. Asoc. Dr | | |
| | | (2) Dr. | | (2) Dr. | | |
| | | (0)Dr. proc. | | (0) Dr. proces | | |
| | | (5) Msc | | (2) Msc. | | |
| TOTAL (2022-2023) | 7 | (3) Prof. Dr. | 2 | (0) Prof. Dr. | 0 (P. ndihmes akademik) | 9 |
| | | (0) Prof. Asoc. | | (1) Prof. Asoc. Dr | | |
| | | (1) Dr. | | (2) Dr. | | |
| | | (0)Dr. proc. | | (0) Dr. proces | | |
| | | (3) Msc | | (3) Msc. | | |
| TOTAL (2021-2022) | 7 | (2) Prof. Dr. | 0 | (0) Prof. Dr. | 0 (P. ndihmes akademik) | 7 |
| | | (0) Prof. Asoc. | | (0) Prof. Asoc. Dr | | |
| | | (2) Dr. | | (0) Dr. | | |
| | | (0)Dr. proc. | | (0) Dr. proces | | |
| | | (3) Msc | | (0) Msc. | | |

*5. Rregullore e njesise kryesore FE;*
*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për | Ndonëse në RVB është theksuar angazhimi I personelit ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e prakikave profesionale, evidencat e paraqitur nga institucioni tregojnë mungesë në këtë drejtim. *GVJ rekomandon njësinë bazë të ndërmarrë masa përmes përcaktimit të përsonelit ndihmës.* |

| | |
|---|---|
| realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Fakulteti I Ekonomisë bazuar edhe ne Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 0/2015, nenet 40 dhe 41 në Statut të KUR dhe nenit 22 të Rregullores së Përgjithshme ka aprovuar edhe koordinatorin akademik për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Eknomike" Koordinatori akademik në funksionet e tij ka ndjekjen e ecurisë së procesit mësimor, administron dokumentacionin mesimor, ndjek veprimtarinë në lidhje me pranimet dhe transferimet e studentëvë dhe në bashkëpunim me përgjegjesin e DF propozon kriteret e pranimit dhe kandidaturat e personelit akademik dhe ndihmës të tij<br>*29. Vendim per caktimin e koordinatorit te programit mesimor*<br>*49. Detyrat e koordinatorit te programit te studimit ne KUR* |
| **Konkluzione** | *GVJ evidenton se programi i studimit ka një plan mësimor të qartë. Programi i studimit nuk është program i akredituar dhe tashmë është në process të vlerësimit për herë të pare të tij. Programi i studimit angazhon një staf akademik me përvojë dhe eksperience. Rregullorja në lidhje me Mësimin e KUR përmes dispozitave të saj ligjore përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore, bazë . koordinatorit akadmik dhe rolet dhe funksionet e tyre në drejtim të procesit mësimor dhe asistencës ndaj studentëvë. .* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës ku zhvillohet edhe programi i studimit zotërojnë të gjithe dokumentat institucionalë që garantojnë cilësinë e procesit mësimor. Konkretisht dokumentat bazë që japin edhe informacion në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve janë si vijon më poshtë:<br>*a.* Rregullorja e përgjithshme e KUR<br>*b.* Rregullore e FE-së<br>c. Rregullore e programit të studimit ;<br>d. Rregullore për zhvillimin e provimeve Rregullore për diplomimin e studentëvë |

| | |
|---|---|
| | e. Programi dhe plani mësimor i programit të studimit Syllabuset për çdo program lëndor<br>Informacioni është I aksesueshëm edhe ne ëebsite. Sesioni "Studentët" ka rubrikat e tij që japin informacion në lidhje me transferimet, ekuivalentimet, provimet etj [https://unireald.edu.al/studentet].<br><br>KUR Ndjek një procedurë të qartë në lidhje me menaxhimin dhe arkivimin e dokumentacionit. KUR ka hartuar dhe aprovuar rregulloren për Arkivën e cila zbatohet në tërësi të tij . Dokumetacioni ruhet dhe protokollohet.Sekretaria mësimore, zyra e Burimeve Njerëzore jane strukturat bazë për arshivimin e dokumentacionit në lidhje me studentët dhe stafin akademik ndërsa sekretaria në fakultete dhe njësi bazë protokollon shkresat në lidhje me vendimet për procesin mësimor<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*5. Rregullore e njesise kryesore FE*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike*<br>*7. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve – 2018*<br>*10. Rregullore e Diplomimit te Studenteve*<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024*<br>*18. Syllabuset - Viti I, II, III]*<br>*95. Rregullore e Arkives në KUR*<br>*vizitë në institucion* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Organizimi i programit të studimit Bachelor në "Informatikw Ekonomike" dhe lëndët e ofruara janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi përcaktuar nga MASR . Referuar programit të studimit ndarja sipas kategorive në të cilat përfshihen lëndet dhe modulet është si vijon më poshtë:<br>• Kategoria A: 36 ECTS;<br>• Kategoria B: 98 ECTS;<br>• Kategoria C: 22 ECTS;<br>• Kategoria D: 18 ECTS;<br>• Kategoria E: 6 ECTS;<br><br>Studimet në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" organizohen në lëndë dhe module dhe vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Numri i lëndëve në total është 33 duke përfshirë praktikën profesionale dhe temën e diplomës. Format e testimit janë provim në 31 lëndë, praktika profesionale është me mbrojtje dhe diploma është me përgatitje të temës nga ana e studentit ose pjesëmarrje në provim formimi. Sipas planit mësimor në semetrin e dytë të vitit të tretë studenti frekuenton praktikën profesionale (6 ECTS) dhe në fund të këtij semestri pasi ka mbyllur të gjithë detyrimet në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e përgjithshme të institucionit |

përgatit temën e diplomës ose hyn në provim formimi e cila është vlerësuar me 6 ECTS.

Lëndët janë ndarë sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e oreve në auditor. Programi zgjat 6 semestra. Neni 14 në Rregulloren e Programit të Studimit përcakton se programi i studimit zgjat tre vite akademike dhe kohëzgjatja maksimale nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të tij .Plani mësimor përmban informacion në lidhje me orët që zhvillohen në auditor dhe jashtë saj. Konkretisht për këtë program studimi GVJ konstaton:

*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*
*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike*
*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024*
*Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike*

| **Ngarkesa në programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike"** | | |
|---|---|---|
| **Format e mësimdhënies** | **Orët në auditor** | **Orë punë të panvarur** |
| Leksione | 935 | |
| Seminare | 505 | |
| Ushtrime/ praktikë lëndore/ laborator | 625 | |
| Praktikë profesionale | 80 | |
| Diplomë/Provim formimi | 150 | |
| **Total** | **2105** | **2395** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Institucioni përcakton qartë informacionin ne idhje me kriteret e pranimit të studentev në programin e studimit. Kreu 3, neni 8 dhe 9 në Rregulloren e programit të studimit përshkraun aplikimin e kandidatëve dhe procedurat e përzgjedhjes Përzgjedhja e studentëve bëhet nga nje komision i caktuar nga Fakulteti i Ekonomisë dhe metoda e përzgjedhjes konsiston në përzgjedhjen e studentëve nëpërmjet konkurrimit të dosjeve .Programi I studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përmban informacion në lidhje me transferimet e studentëvë. Neni 12 në Rregulloren e programit të studimit përshkruan dispozitat në lidhje me kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve. Informacioni është transparent edhe ne ëebsite ne sesionin "Studentët":https://unireald.edu.al/studentet/transferime-dhe-ekuivalentime/. GVJ kreu vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe në mënyrë rastësore shqyrtoi dosje të studentëvë të regjistruar dhe të transferuar dhe konkludon qe praktikat e ndjekura nga institucioni janë në përputhshmëri me dispozita ligjore të shprehur ne rregullore të KUR dhe të programit të studimit dhe në përputhshmëri më kornizat ligjore Në takimin me stafin akademik u sollën shembuj të transferimeve kryesisht nga Kolegji "Panvarësia" e cila u mbull dhe shumë studentë janë transferuar në këtë program studimi |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><th>Sipa viteve akademikë</th><th>Të regjistruar për herë të parë</th><th>Të transferuar</th><th>Total</th></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td></tr>
<tr><td>2023-2024</td><td>12</td><td>6</td><td>18</td></tr>
<tr><td>2024-2025</td><td>21</td><td>6</td><td>27</td></tr>
</table>
<br>
6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike]<br>
4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar;<br>
Ref.VKM.nr.41 date 24.01.2018<br>
takim me stafin akademik,<br>
vizitë në sekretari
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</td>
<td>Për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E.<br>
GVJ u njoh me secilin prej tyre dhe konstaton që syllabuset japin informacion në lidhje me titullarin e lëndës, ngarkesën kodin e lëndës, përmbledhje dhe rezultate të të nxënit, Konceptet themelore , temat e lëndëve të specifikuar sipas javëve kalendarike, format e kontrollit të lëndëve duke specifikuar masën e frekuentimit, vlerësimi në kontrollin e vazhdueshëm dhe provimin përundimtar dhe përshkrim mbi literaturën e deturuar dhe ndihmëse<br>
GVJ është i mendimit që programi përmban elementët e kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" . GVJ konstaton se syllabuset nuk përmbajnë tematikat në lidhje me orët e ushtrimeve dhe orët e punëve laboratorike. Bazuar në planin mësimor konstatojmë se një pjesë e ngarkesës në auditor është orë laboratike, ushtrime dhe seminare dhe GVJ rekomandon që institucioni duhet te garantojnë përfshirjen e tyre në syllabus përkatesisht në secilën javë ]. Literatura e detyruar dhe ndihmëse në shumicën e syllabuseve nuk është e 5-10 vite te fundit dhe për këtë GVJ rekomandon përmirësimin e saj nga ana e stafit akademik<br>
Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike<br>
18. Syllabuset - Viti I, II, III<br>
Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike; 14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike.</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të</td>
<td>Programi përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme. Konkretisht lëndët në fushën e informatikës predominojne dhe përmirësimet janë bërë në tematika të veçanta në syllabus . Nga takimi me përgjegjësin e njësisë bazë u theksua nga ana e tij qe programi I studimit nuk ka pësuar</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | ndryshime pasi edhe nga ana e studentëvë nuk është kërkuar në sondazhet që janë bërë për vlerësimin e programit të studimit *[takim nr.1 në institucion]*. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FE dhe DF disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe vënien në funksionim të programit të studimit të ciklit të parë "Informatikë Ekonomike". Organizimi i programit të studimit si dhe lëndët e ofruara në të janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të parë të studimeve, siç janë të përcaktura në VKM nr. 41, 24.01.2018. Programi krijon mundësi në thellimin e njohurive në përputhje me kriteret e vendosura. Lëndët janë të ndara sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi i studimit zgjat tre vite me dhe çdo vit akademik ka 60 ECTS. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën mbi 20%.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Objektivi kryesor i programit të studimit "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" është t'u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, etj., me objektiv kryesor formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë . Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve. |

| **Programi Bachelor në "Informatikë Ekonomike"** | | |
|---|---|---|
| **Semestri** | **ECTS** | **Nr. i lëndëve** |
| Semestri I | 34 | 6 |
| Semestri II | 26 | 5 |
| Semestri III | 30 | 5 |
| Semestri IV | 30 | 6 |

| | | |
|---|---|---|
| Semestri V | 27 | 5 |
| Semestri VI | 33 | 6 (praktika profesionale dhe diplomimi) |
| **Total** | **180** | **33** |

Programi mësimor një vëmëndje të veçantë i jep pjesës së ushtrimeve, orëve laboratorike dhe projekteve të kursit. Në total vërejmë 935 orë leksione dhe 1210 orë praktikë duke demonstruar që kjo e fundit prevalon . Bazuar në raportin e lëndëve Informatikë dhe Ekonomi konstatojmë se fusha e informatikes dominon

*14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike*
*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024;*
*Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike*

| **Viti akademik** | **Numri I lëndëve në fushën e informatikës** | **ECTS** | **Numri I lëndëve në fushën e ekonomisë** | **ECTS** |
|---|---|---|---|---|
| Viti I | 5 | 27 | 2 | 9 |
| Viti II | 3 | 19 | 4 | 20 |
| Viti III | 6 | 33 | 2 | 10 |
| **Total** | **14 (43.9%)** | **79** | **8 (21.7%)** | **39** |

*Bazuar në të dhënat e mësipërme GVJ propozon që programi duhet të forcojë kompetencat e studentit edhe në fushën e ekonomisë duke i siguruar nje specializim më të mirë edhe në këtë fushë.*

**Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.

GVJ bazuar edhe ne standartet më sipër konstaton se programi mësimor Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është i hartuar për të balancuar ngarkesën teorike me praktikën në një raport 44.4%: 52.3%. Ky ekuilibër është evident duke garantuar në fund të çdo viti akademik plotësimin e 60 ECTS. Programi i studimit, lëndët, shpëndarja në vite dhe semestra, vlerësimi në kredite dhe orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit te studimit.

| **Viti** | **Lëndët për secilën kategori** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **"A"** | **"B"** | **"C"** | **"D"** | **"E"** |
| I | 3 | 5 | 1 | 2 | - |
| II | 3 | 7 | 1 | - | - |
| III | 1 | 6 | 2 | 1 | 1 |
| **Total** | **7** | **18** | **4** | **3** | **1** |

*14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike*

**Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me

GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor në universitete brenda vendit. GVJ u njoh me punën që është bërë në procesin e hartimit të programit të studimit dhe marrja e modelit më të mirë me programin

| | |
|---|---|
| programe të ngjashme ndërkombëtare. | nga Universiteti I Vlorës, Universiteti I Salernos me të cilët KUR ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi<br>*vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. Në lidhje me mobilitetin e studentëvë konstatojmë një angazhim shumë të dobët në këtë drejtim.*Programi i studimit nuk ka të diplomuar për periudhën 2022 – 2024 dhe për këtë GVJ nuk mund të japë mëndim në lidhje me punësimin e tyre në përfundim të studimeve*.Në takimin e zhvilluar me studentët, pritshmëritë e tyre në lidhje me punësimin janë në aeroportin e Vlorës, në biznese private, online për shtete të tjera apo edhe punësim jashtë vendit<br>*102. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - Informatike Ekonomike*<br>*takim me studentët* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Syllabuset përmirësohen ne tematika të vecanta por sic u theksua edhe më sipër në standartin II.3, kriteri 4 GVJ rekomandon domosdoshmërinë e rifreskimit të literaturës së detyruar dhe ndihmëse më ato të 5 viteve të fundit ndonëse edhe ne takime u shpreh problematika në gjetjen e literarurës në fushën e informatikës në gjuhën shqipe<br>*vizitë në institucion* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të pare. Nga takimet me studentët rezulton se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre. Ata shprehen se raporti teori-praktikë është I duhur dhe predominon më shume fusha e informatikës.<br>*Ev. Takim me studentët* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Përmbajtja e programit mundëson studentët të thellojnë njohuritë e tyre në programe të mëtejshme. Në takimin me studentët një pjesë e tyre shprehën dëshirën për studime të thelluara por duhet theksuar që departamenti I Financës nuk ofron program në ciklin e dytë<br>*takim me studentët* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Infromatikë Ekonomike" është një program i cili kombinon pjesën teorike me atë praktike. Programi mësimor ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve.Programi mësimor është hartuar me* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentin në fund të diplomimit të tij. Programi i Studimit, lëndët-modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit.Vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. KUR përcakton qartë në rregullore kriteret dhe procedurat në transferimin e studimeve.*<br>*Programi i studimit nuk ka të diplomuar për periudhën 2022 – 2024 dhe për këtë GVJ nuk mund të japë mëndim në lidhje me punësimin e tyre në përfundim të studimeve* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Programi Bachelor në "Informatikë Ekonomike" nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën 20%. Programi nuk ka diplomuar akoma studentët për peridhën 2022-2024 dhe për këtë akoma nuk janë mbledhur nga institucioni të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve në përfundim të studimeve të tyre. Në takimin me stafin akademik janë bërë përmirësime të ndërmarra nga ana e tyre përmes iniciativave privatë duke matur zhvillimet e fundit në fushat përkatëse. Institucioni nuk ka ndërmarrë studime tregu dhe pyetsorët e studentëve nuk kanë shprehur problematikë në lidhje me cilësine e procesit mësimor *[takim me stafin akademik].* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | KUR nxit perfshirjen e stundetëve dhe marrjen e mendimit të tyre në lidhje me përformancëb e stafit akademik dhe në lidhje me institucionin. Të dhënat përpunohen nga zyra e NSBC dhe diskutohen në nivel departamenti . *GVJ konstaton që të dhënat e mbledhura nga studentët mungojnë në raportet vjetore dhe rekomandon përfshirjen e tyre te shoqeruar edhe me rekomandimet përkatëse.*<br>*48. Pyetesor qe plotesohet nga studentet, per kushtet ne IAL;*<br>*47. Formular i NJSBC- vleresim i studentit per pedagogun* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, | Njësia bazë ka nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private për përfshirjen e studentëve në praktika |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | profesionale. KUR bashkëpunon ngushtë me Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe Universitetin e Salernos në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit. GVJ konstaton se programi është i ri dhe njësia bazë ndonëse bashkëpunon më partnerë të ndryshëm nuk ka ndërmarrë përmirësime mbi masën 20% *takim në insitucion, RVB* | | | |
| **Konkluzione** | *KUR ka nenshkruar marrëveshje bashkëpunimi më institucione rajonale dhe qëndrore dhe me universitete jashtë vëndit. KUR ka ngritur NJSBC për të garatuar cilësinë e procesit mësimor. Nëë fund të cdo semestri NJSBC na bashkëpunim me DF organizon edhe anketime ku përthithet mendimi I studentëvedhe hartohen raporte analitike.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Një orë mësimore e ka kohëzgjatjen 60 minuta. Format e studimit janë të shprehur në nenin 6 në Rregulloren e programit të studimit Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, projektet dhe detyra, praktikat, seminare të parashikuara në programin mësimor. GVJ konstaton zbatimn e ketyre formave në procesin mësimor dhe pasqyrimin e tyre në ngarkesa specifike në planin mësimor<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike*<br>*14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda të ndryshme (që varen edhe nga specifika e lëndëve) për të rritur interesimin për orën e mësimit dhe për të rritur shkallën e përvehtësimit të informacionit të transmetuar.Personeli akademik I përgjigjet kërkesave të studentëvë. Në takimin e zhilluar në institucion u sollën shembuj të përdorimit të rasteve studimore, teknikave për ta bërë sa më të kuptueshme mësimdhënien tek studentët. Nga takimi me studentët nga ana e tyre u theksua veshtirësitë në lëndën e matematikës ndërsa lëndët në fushën informatikës nuk paraqesnin vështirësi. Orët në laboratorë dhe shembujt e shumta të sjellë nga stafi e bënin më të lehtë tek ata asimilimin e njohurive *takim me studentët* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Institucioni vë në dispozicion infrastrukturë të duhur të pajisur me mjetet e duhura didaktike për të garantuar procesin mësimor Stafi akademik përdor edhe platformen open-acces, Google Classroom dhe ka hartuar edhe nje manual për studentët dhe pedagogun<br>*34. Te dhena per infrastrukturen ne funksion te programit te studimit;*<br>*35. Laboratori i Informatikës ne IAL*<br>*61. Google Clasroom - Manual per studentet;*<br>*62. Manual per programin OBS per regjistrim video dhe audio;*<br>*63. Google Clasroom - Manual per pedagogët* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te | Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë. Titullarët e shprehur në këto lëndë janë më gradën shkencore Dr porn ë mësimdhënie janë të shumtë stafi akadmeik me gradën shkencore MSc. Bazuar për ëtë GVJ rekomandon fuqizimin e njësisë bazë me staf akademik me grada shkencore duke rritur edhe mundësitë për hapjen e |

<table>
<tr><td>student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</td><td colspan="4">programit të ngjashëm në ciklin e dytë Konkretisht për vitin 2023-2024 janë angazhuar stafi akademik si vijon në tabelën më poshtë:<br><table><tr><th colspan="2">Programi Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (2023-2024)</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr.</td><td>8</td></tr><tr><td>MSc.</td><td>12</td></tr></table></td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</td><td colspan="4">GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë personeli akademik për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit) si dhe nga drejtuesi i njësisë bazë.Tw dhwnat reflektohen eedhe ne raportin vjetor<br>18. Syllabuset - Viti I, II, III<br>31. Analize e njesise baze per arritjen e objektivave te programit</td></tr>
<tr><td>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</td><td colspan="4">Për rregullimin e veprimtarisë mësimore KUR ka ngritur edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila është strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Veprimtaria e saj mbështetet në një rregullore të aprovuar nga Senati Akademik. Struktura e saj është kolegjiale dhe përbëhet nga 5 anëtarë ku 3 janë përfaqësues të përsonelit akademik të njësisë kryesore, 1 përfaqësues I Këshillit Studentor dhe 1 Ekspert I Jashtëm.<br>Neni 7 në Rregulloren e NJSBC-së përcaktojnë që kjo njësi bashkëpunon me njësinë bazë për rishikimin periodik të programit të studimit dhe ndërmerr sondazhe me studentët për vlerësimin e procesit mësimor dhe të punës së stafit akademik<br>8. Rregullore e NJSBC./; 87. Plan pune i NJSBC. Viti akademik 2023-2024</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ se kur ka hartuar udhëzues në lidhje me mësimdhënien, mësimnxënien dhe cilësinë në procesin mësimr. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është më përvojë dhe eskperiencë. Programi i studimit përfshin studentët në dhënien e mendimit dhe vlerësimit të tyre në lidhje me punën e personelit akademik përmes anketimeve periodike që kryen njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
</table>

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret e vlerësimit dhe testimit të njohurive përcaktohen qartë në Rregulloren e Përgjithshme të KUR Kreu VII jep informacion në lidhje me format e kontrollit të dijeve. Rregullorja e programit të studimit në nenin 6 përban format e studimit por GVJ konstaton mungesë të pasqyrimit të formave të kontrollit të dijeve dhe për këtë rekomandon përmirësimin e saj me këto elemente .Rregullorja baze institucionale është e aksesueshme edhe në website të KUR<br>*[https://unireald.edu.al/legjislacioni/rregullore-e-unireald/]*<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentët, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik në fillim të lëndës. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar;*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike;*<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024;*<br>*18. Syllabuset - Viti I.II, III* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | GVJ përmes shqyrtimit të evidencave të paraqitur nga institucioni konstaton në përmbajtjen e tyre klauzola ligjore që përcaktojnë qartë format e testimit dhe mënyrën e organizimit të kontrollit dhe testimit të dijeve . Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në disa forma ku më kryesoret përmendim si vijon më poshte:<br>- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive – 5%;<br>- Plotësimi i detyrimeve (lboratorike, detyrave të kursit) – 5%;<br>- Testimet gjate vitit- 30%;<br>- Provimi përfundimtar – 60%;<br>*GVJ konstaton se në Rregulloren Themelore dhe në Rregulloren për programin e ciklit të dytë të studimit mungojnë të dhënat në lidhje me format e vlerësimit të njohurive dhe format e kontrollit të vazhdueshëm dhe rekomandon përfshirjen e tyre.* |

| | |
|---|---|
| | Format e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar edhe në syllabuse dhe konstaton vlerësime të ndryshme në varesi të lëndës dhe mënyrës së saj të organizimit<br>Elementët bazë të procesit mësimor janë mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, detyra/projekte kursi. Elementët bazë të procesit mësimor janë të shprehur qartë në syllabusin e secilës lëndë të programit mësimor. Në vlerësimin e dijes stafi akademik mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm, vlerësimin në detyra/projekte kursi dhe vlerësimin në provimin final. Rezultati i testimit të dijeve është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm të bërë gjatë gjithë semestrit . KUR ka hartuar edhe nje rregullore per zhvillimin e provimeve duke garantuar korrektesinë në këtë process<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*18. Syllabuset - Viti I; II, III*<br>*7. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve – 2018* |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | GVJ zhvilloi një takim të veçantë me stafin akademik ku këta të fundit shprehën qartë mendimin e tyre në lidhje me ecurinë e studentëve. Stafi akademik ndjek në vazhdimësi progresin e studentëve Ndërsa ne takimin e zhvilluar me studentët u theksua puna e bërë nga stafi akademik në lidhje me ndjekjen e progresit të studentëve. Sidomos në drejtim të aftësimit praktik të tyre<br>*takim me stafin akademik, takim me studentët* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Nga takimet me studentët dhe personelin akademik të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", GVJ konstatoi stafi akadmeik fokusohet shumë në aftësimin praktik të studentëve. Nga ana e tyre përdorn shume raste praktike sidomos ne fushën e ekonomisë ndersa në fushën e informatikës intesifikohen shume puna në grup për detyrat e kursit dhe orët laboratorike<br>*takim me stafin akademik, takim me studentët* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se KUR ka hartuar rregulloret mbi bazwn e tw cilave zhvillohet dhe garantohet procesi mwsimor. Elementët bazë të procesit* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *mësimor janë mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, detyra/projekte kursi. Elementët bazë të procesit mësimor janë të shprehur qartë në syllabusin e secilës lëndë të programit mësimor.*<br>*GVJ konstaton se në Rregulloren Themelore dhe në Rregulloren për programin e ciklit të dytë të studimit mungojnë të dhënat në lidhje me format e vlerësimit të njohurive dhe format e kontrollit të vazhdueshëm dhe rekomandon përfshirjen e tyre.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Kriteret dhe procedurat për testimin e njohurive të studentit janë përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme të KUR (kapitulli VII, neni 57 -60 ), dhe në syllabuset e lëndëve *GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit nuk përmban një kapitull të veçantë në lidhje me format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve dhe për këtë rekomandon Institucionit të bëjë plotësimet e duhura në këtë rregullore* Kontrolli I dijes së një lënde bëhët nga titullari i lëndës duke u mbështetur në programin mësimor. GVJ konstaton se për të përmbushur kriteret ligjore në shumicën e lëndëve titullarë janë stafi akademik me gradën shkencore Dr ndonëse realisht këto lëndë zhvillohen edhe nga staf akademik me gradën MSc tw cilwt bwjnw edhe testimin e njohurive dhe vlerwsimin e dijeve tw marra nga studenti. Kontrolli i njohurive në këtë cikël studimi bëhët semestrale dhe realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet provimit të pjesshëm, provimit final dhe duke përfshirë edhe forma të vlerësimit të theksuara në programet lëndore . Vlerësimi bëhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në syllabus. GVJ evidenton se vlerësimi varion në lëndë në varësi të peshës së lëndës dhe mënyrës së organizimit të saj..Rezultati i testimit të dijeve është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm të bërë gjatë gjithë semestrit Elementët kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet e pjesshme, punimet/projektet, provimi final etj. KUR ka hartuar edhe nje rregullore per zhvillimin e provimeve duke garantuar korrektesinë në këtë proces<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike;*<br>*18. Syllabuset - Viti I., II, III*<br>*7. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve – 2018* |

<table>
<tr>
<td>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</td>
<td>KUR zhvillon procedurat e provimit bazuar në dispozita ligjore të përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme të KUR dhe në rregulloren e zhvillimit të provimeve . Provimet behen me sekretim duke ruajtur anonimatin por KUR nuk zhvillon një sistem elektronik të testimit dhe vlerësimit.<br>4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar<br>7. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve – 2018</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</td>
<td>Mënyra dhe forma e përcaktimit të vlerësimit përfundimtar jepen qarte në Rregulloren e Përgjithshme të KUR dhe në syllabuset e lëndëve . GVJ gjatë takimin me stafi akademik konstaton se nga ana e tyre zhvillohen forma të ndryshme të vlerësimit të studentit përgjatë vitit shkollor. Stafi akademik solli në vëmendje presantimet, detyrë/projekt kursi i cili mund të zhvillohet nga ana e studentit individuale ose në grup . GVJ gjatë shqyrtimit të syllabuseve vëren se studenti duhet të frekuentojë të paktën 60% të orëve në leksion, 75% të orëve në seminar/ushtrime dhe 100% orët laboratorikë/ praktika mësimore/profesionale. Në të gjithë syllabuset konstatohet se aktivizimi vlerësohet me 10%, provimi I ndërmjetëm 30% dhe provimi final me 40% . Një pjesë e lëndeve në syllabus organizohen ne leksione, seminare, orë laboratorike por GVJ nuk gjen evidenca të vlerësimit të studentit ndaj detyrimeve. Në tabelën përmbledhëse të paraqitur nga institucioni (Tabela 15) konsttaojmë se format e kontrollit të njhurive janë:
<table>
<tr><th>Format e kontrollit të njohurive</th><th>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”<br>Pjesa (në %) ndaj totalit</th></tr>
<tr><td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td><td>5%</td></tr>
<tr><td>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)</td><td>5%</td></tr>
<tr><td>Testimet gjatë vitit</td><td>30%</td></tr>
<tr><td>Provimi përfundimtar</td><td>60%</td></tr>
<tr><td>Në total</td><td>100%</td></tr>
</table>
GVJ konstaton një mungesë të vlerësimit të studentit kundrejt detyrave te kursit, projekteve apo puneve laboratorike dhe rekomandon paraqitjen e tyre ne Rregulloren e Përgjithshme të KUR dhe në rregulloren e programit të studimit. GVJ ndërmorri një vizitë në sekretarinë mësimore. Përmes një verifikimi të notave të hedhur në regjister me rezultatet ne proçesverbalet e dhëna nga stafi akademik konstaton se studentët janë vlerësuar korrekt dhe në përputhje me nenet e përcaktuar në dispozitat ligjore.<br>4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar;<br>6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike<br>18. Syllabuset - Viti I, II, III</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Bazuar në Rregulloren e Përgjithshme në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim përgjegjësit të departamentit që mbulon lëndën përkatëse<br>GVJ zhvilloi një takim të veçantë me stafin akademik ku këta të fundit shprehën qartë mendimin e tyre në lidhje me ecurinë e studentëve. Stafi akademik ndjek në vazhdimësi progresin e studentëve. Në përfundim të provimit studentët njihen me zgjidhjet korrekte dhe bëjnë vlerësimin në lidhje me produktin e dhënë nga ana e tyre në provim. Bazuar në rezultatet e testimt të ndërmjetëm stafi akademik zhvillon një seancë sqarimi ku teza ripunohet në një orë mësimi duke paraqitur edhe zgjidhjen korrekte<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*takim me stafin akademik, takim me studentët*<br>*73. Model testi per kontrollin e njohurive i shoqeruar me komente* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | KUR në dispozitat ligjore ka theksuar edhe penalitetet kundrejt kopjimit në detyra, provime plagjaturën. Konkretisht neni 73 në këtë rregullore përcakton edhe masat disiplinorë në raste te evidentimit të kopjimi në provime nga ana e studentit .<br>Institucioni ka hartuar një rregullore të veçantë për organizmin e provimit dhe një procedurë e qartë realizohet në lidhje me ngritjen e komisionit të provimeve, firmosjen nga ana e tyre e vleresimt të provimeve . GVJ gjeti evidencë të përdorimit të sistemi antiplagjaturë por për Buletinin REALD dhe aspak për përmbajtjen e temave të diplomave<br>*4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar*<br>*92. Rregullore Antiplagjiature*<br>*9. Rregullore e Sekretarise Mësimore*<br>*7. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve – 2018* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Nga diskutimet me lektorë dhe studentë të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", GVJ konstatoi se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, i korrespondojnë një vlerësimi të shtrirë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës duke reflektuar gjithë komponentët e formimit<br>*Ev. Takime në institucion* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | KUR përmes rregulloreve bazë përcakton qartë të drejtat e studentit për tu njohur me vlerësimin dhe të drejtën e tij për ankimimin. Neni 58 në Rregulloren e Pwrgjithshme tw KUR përcakton qartë që Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet bëhen të njohura brenda 3 ditëve nga dita e zhvillimit të tij. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe printohet proces verbali, firmoset nga lektori dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore në 2 (dy) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje qëndron në sekretarinë mësimore, 1 (një) kopje në departamentin |

| | |
|---|---|
| Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | përkatës. Neni 59 pwrcakton se studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit brenda 24 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit [4. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar]. GVJ në takimin e zhvilluar me studentët konstaton njohje nga ana e tyre e procedurave për marrjen e vlerësimit brenda afatave kohore dhe të drejtën për ankimin por shembuj nga eksperienca e tyre në këtë drejtim nuk u elaboruan *[takim me studentët]*. |
| **Konkluzione** | *GVJ evidenton se programi i studimit ka të përcaktuar format e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit. Elementët bazë të procesit mësimor janë mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, detyra/projekte kursi. Elementët bazë të procesit mësimor janë të shprehur qartë në syllabusin e secilës lëndë të programit mësimor.Syllabuset përcaktojne qartë kriteret e vlerësimit dhe peshën përkatëse. Studentët janë të mireinformuar në lidhje me të drejtat e tyre për ankimim. GVJ konstaton një mungesë të vlerësimit të studentit kundrejt detyrave te kursit, projekteve apo puneve laboratorike dhe rekomandon paraqitjen e tyre ne Rregulloren e Përgjithshme të KUR dhe në rregulloren e programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.4<br>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | GVJ është i mendimit se mënyra e zhvillimit të programit të studimit (me integrimin e detyrave e laboratorëve) dhe njohuritë e përftuara krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve në fushën e aplikimeve të fushës informatike dhe ekonomike. Përmirësimi i vazhdueshëm i programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës garanton edhe aftësimin më të thelluar të studentëve në njohuri dhe praktikë<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024*<br>*18. Syllabuset - Viti I., II, III* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi i studimit përfshin një larmi të gjerë lëndësh/modulesh (sipas kategorive nga A në E) të cilat në përputhje me Udhëzimet e MAS përmbushin kërkesat dhe detyrimet. Në programin mësimor janë vendosur edhe dy grupe lëndë me zgjedhje në fushën e infomatikës dhe ekonomisë të cilat zhvillohen në vitin e tretë:<br>- Fushën e informatikës: Projektim Software, Software Aplikative, Siguria e Informacionit dhe Grafikë Inxhinierike; |

| | |
|---|---|
| | - Fushën e Ekonomisë: Inovacion, Etikë Biznesi;<br>Programi ofron edhe zhvillimin e lëndës së gjuhës së huaj (Anglisht/Italisht) në vitin e parë dhe të dytë e cila I ofron studentëve mundësinë të kenë lehtësi në mobilitet dhe në përdorimin e literaturës së huaj<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë, nga studentët (nëpërmjet pyetsorit që organizihet për cdo lëndë në fund të semestrit akademik) si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit. Raportet vjetore zhvillojnë një analizë të punës së kryesor ndonëse sic është theksuar më lart në këtë raport GVJ konstaton mungesë të plan veprimit në drejtim të përmirësimit<br>*31. Analize e njesise baze per arritjen e objektivave te programit*<br>*47. Formular i NJSBC- vleresim i studentit per pedagogun*<br>*54. Raport vjetor i kerkimit shkencor 2023-2024*<br>*88. Raporti vjetor 2022-2023 dhe shkresa percjellese ne MAS* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Mësimdhënia bazohet në format e përcaktuara në syllabus. Në metodologjinë e të nxënit konsiderohen leksionet, seminaret, konsultimet, puna në grup dhe individuale. Në zhvillimin e kompetencave të studentit organizohen edhe orë të hapura Në javën e fundit të programit zhvillohen edhe një përsëritje e njohurive dhe koncepteve themelore e cila orienton studentët në drejtim të strukturës së provimit përfundimtar Në drejtim të mobilitetit të studentëvë konstatojmë një numër të vogël të tyre. *Konkretisht nga Tabela 16 kanë përfituar mobilitet vetëm 4 studentë dhe rekomandojmë që institucioni duhet të punojë më shumë në këtë drejtim*<br>*takime në institucion, Tabela permbledhese nr. 16*<br>*102. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - Informatike Ekonomike* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë | Personeli akademik mbart një përvojë dhe është i njohur në fushën e ekonomise dhe informatikës. GVJ konstaton nga të dhënat e mbledhura në kuadër të bashkëpunimit nga njësia kryesore janë zhvilluar 10 leksione me lektore te huaj<br>*51. Leksion i hapur me temë Terrorizmi ndërkombëtar, karakteristikat e tij dhe impakti në fushën e sigurisë* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | *102. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - Informatike Ekonomike* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ evidenton se programi i studimit i përgjigjet pritshmërisë së studentëve në drejtim të aftësimit praktik të studentëvë dhe punësimin e tyre në përfundim të studimeve. Personeli akadmeik është më përvoje dhe orienton studentin në drejtim të përthithes së njohurive. GVJ konstaton një numër të vogël mobiliteti për studentët dhe rekomandon forcimin në këtë drejtim.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Programi I studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofron në semestrin e dytë të vitit të tretë temën e diplomës ose provimin përfundimtar e cila vlerësohet me 6 ECTS . Kreu VIII në rregulloren e përgjithshme të KUR përcakton edhe procedurat ligjore qe studenti duhet të ndjekë në lidhje me diplomimin e tij. Kreu IV në rregulloren e programit të studimit përcakton se për të marrë diplomën "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" studentët duhet të japin provimin e përgjithshëm, ose mund të mbrojnë një tezë diplome (mikrotezë) . Të drejtën për të mbrojtur diplomën me punimin e mikrotezës e kanë studentët, të cilët kanë mesatare të përgjithshme të notës jo më pak se nota 8 (tetë) .<br>KUR ka hartuar edhe rregulloren e diplomimit të cili GVJ e gjeti një përsëritje të neneve të shprehur në rregulloren e përgjithshme duke mos theksuar edhe prangun e mesatares që studenti duhet të kalojë për të fituar të drejtën e diplomimit përmes mbrojtjes së temës. *Për sa më sipër GVJ rekomandon hartimin e një rregullore të vecantë për diplomimit duke përfshirë specifikat në lidhje me këtë proces*<br>*13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024*<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike*<br>*10. Rregullore e Diplomimit te Studenteve* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | DEF asiston vazhdimisht studentët në lidhje me sigurimin e informacionit të duhur për përmbylljen e detyrimeve. Stafi akademik është në kontakt të vazhdueshem duke ofruar asistencë studentëvë . Informacioni është publik ne faqen web dhe cdokush mund të informohet në lidhje me mbylljen e detyrimeve për të kaluar në vitin tjeter akademik *https://unireald.edu.al/studentet/*<br>*takim me stafin akadmemik, takim me studentët* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Bazuar edhe ne rregulloren e programit të studimit studentët të cilat kanë mesataren nën 8 kanë të drejtën ti nënshtrohen provimit final . Pyetjet në lidhje me këtë provim konsistojnë në njohuritë e marra gjatë tre viteve kryesisht në lëndët bazë në fushën e informatikës dhe ekonomisë . GVJ konstaton se rregullorja e diplomimit e hartuar nga KUR nuk përmban dispozitat ligjore në lidhje me procesin e organizimit të provimit final dhe për këtë GVJ rekomandon përmirësimin e saj<br>*6. Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike*<br>*10. Rregullore e Diplomimit te Studenteve*<br>*takim me stafin akademik* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | GVJ në takimet e zhvilluara në institucion konstaton se procedura e përgatitjes së temës se diplomës është konform dispozitave të rregullores së diplomimit dhe Rregullores së KUR. Departamenti harton një sërë temash të ciat përzgjidhen nga studenti. Udheheqesit e diplomave miratohen ne department dhe me pas aprovohen nga Rektori I KUR. Institucioni ka hartuar edhe nje udhëzues në lidhje me formen e pergatitjes së temës së diplomës dhe zbaton sistemin antiplagjaturë në lidhje me përmbajtjen e tyre<br>*46. Udhezuesi per punimin e temes se diplomes* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | GVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike në institucion për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, mund të ofrohen mundësi për të kryer matje apo teste edhe në biznese apo institucione që mbulojnë problematikën që lidhet me temën e diplomës ose ku studentët kryejnë edhe praktikat profesionale<br>*takime ne institucion* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Mbrojtja e temës së diplomës bëhët e hapur. Procedura përfshin një paraqitje të përmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim komisioni bazuar edhe në vlerësimin e udhëheqsit dhe punimin e studentit bën vlerësimin me notë. Komisioni dhe kryetari I tij miratohen nga Dekanati I Fakultetit të Ekonomisë me propozim të përgjegjësit të Departamentit të Ekonomisë dhe Financës dhe përbëhët nga 5 vetë<br>*10. Rregullore e Diplomimit te Studenteve*<br>*79. Modeli i punimit te diplomes - kapaku i mikrotezes* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga | Në përfundim të studimeve të ciklit Bachelor në "Informatikw Ekonomike", studentit i vihet në dispozicion diploma (sipas modelit të miratuar nga MASR) dhe suplementi i diplomës së bashku me listën e notave |

| | |
|---|---|
| ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | *13. Programi mësimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike 2024*<br>*15. Modeli i diplomes Bachelor ne Informatike Ekonomike*<br>*16. Liste Notash - Ba. Informatikë Ekonomike*<br>*17. Suplementi i Diplomes Ba. në Informatikë Ekonomike* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Referuar DVV, rezultati i provimit ose mbrojtjes së diplomës ruhet në Sekretarinë Mësimore . Gjithashtu, në Sekretaritë mësimore mbahet rregjistri bazë i studentëve me të dhënat e tyre personale si dhe vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit . Krahas versionit të shkruar (letër), për menaxhimin e përditshëm mbahet edhe versioni elektronik i informacionit.<br>*vizitë në sekretarinë mësimore*<br>*Pjesë nga regjistri themeltar i studentëve* |
| **Konkluzione** | *GVJ evidenton se programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përmban në semestrin e dytë të vitit të tretë mbrjotjen e temës së diplomës nëse studenti zotëron jë mësatare mbi 8. Bazuar në evidencat e paraqitura GVJ konstaton se kjo procedurë zhvillohet nga ana e njësisë bazë në përputhje me klauzolat ligjore të shprehur në Rregulloren e KUR dhe nw rregulloren e programit te studimit. Stafi akademik mbështet studentin gjatë përgatitjes së tij. Tema e diplomës vlerësohet nga nje komision i ngritur me pesë anëtarë nga njësia bazë. Në përfundim të tij studenti pajiset me diplomën dhe suplementin saj.GVJ rekomandon përmirësimin e rregullores se diplomimit duke u pasuruar me informacion në lidhje me organiziminn e provimit përfundimtar për atë kategoi të studentëve të cilët nuk e kalojnë pragun e mesatares mbi 8.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1** |
|---|






**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | (shih më poshtë) |

| Tituj/grada | 2022-2023 | | 2023 – 2024 | | 2024 – 2025 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 1 | - | 1 | - | 1 | - |
| Prof.As. Dr | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dr/PhD | 2 | 3 | 2 | 1 | 3 | 2 |
| Msc | 2 | - | 4 | | 4 | 0 |
| **Në total** | **5** | **3** | **7** | **1** | **8** | **2** |

Referuar dosjes së vetëvlerësimit, konstatohet se stafi akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", përmbush kërkesat ligjore, për nivelin e kualifikimit akademik dhe për fushën e ekspertizës. Në këtë program studimi gjate 2024-2025, janë të përfshirë 10 pedagogë gjithsej, ndër të cilët 8 janë staf efektiv (PAE) dhe 2 staf me kontratë (PAK). Vihet re që stafi akademik i angazhuar në program është rritur krahasuar me vitin 23-24, ku ka qenë të përfshirë 8 pedagogë. *Pavarësisht rritjes në numër të stafit akademik në vitin e fundit, (5. Tabelat permbledhese te stafit, vizita ne institucion, Tabela 2). GVJ duke konsideruar numrin e lëndëve dhe stafin aktual të angazhuar, sugjeron rritjen e numrit të stafit akademik me tituj dhe grada të përfshire në program, pasi 40% e stafit akademik janë "asistent lektor".*

Koordinatori i programit, është caktuar me shkrese zyrtare dhe eshte nje prej pedagogeve te programit te studimit me titullin Msc., njeherazi edhe koordinator i praktikes mesimore.

Stafi administrativ është në nivel fakulteti, për shkak të numrit të vogël të studentëve.

*Evidenca nr. 89. Lista e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit në 2 vitet e fundit Ba. Informatikë Ekonomike.pdf*

*Tabelat përmbledhëse për stafin akademik të departamentit dhe stafit në programin - Informatikë Ekonomike...pdf (dokumenta shtesë, pas vizitës në institucion)*

*Vendim per caktimin e koordinatorit te programit mesimor.pdf*

<table>
<tr>
<td>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</td>
<td>Referuar, Tabeles, 12.1, 12.2, (102.Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - Informatike Ekonomike...pdf), per dy vite akademike si dhe per vitin 24-25, që u sigurua nga vizita ne institucion, (5.Tabela 3.Shperndarja e ngarkesës mesimore të stafit akademik ne programin e studimit Bachelor në “Informatike Ekonomike”, për tre vitet e fundit), rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë.
<table>
<tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr>
<tr><td>2024-2025</td><td>2115</td><td>1645</td><td>470</td><td>77.8% / 22.2 %</td></tr>
<tr><td>2023-2024</td><td>1405</td><td>1205</td><td>200</td><td>86%/14%</td></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>705</td><td>705</td><td>0</td><td>100%/0%</td></tr>
</table>
Referuar ngarkesës mësimore dhe stafit akademik që e mbulon, rezulton se për tre vitet e fundit akademike ngarkesa që mbulohet nga personel akademik efektiv është nga 77.8%-100% të ngarkesës totale, cfarë është në përputhje me bazën ligjore, ku ngarkesa e mbuluar nga stafi akademik efektiv duhet të jetë mbi 70% e ngarkesës së programit. (Tabela 12, 102. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - Informatike Ekonomike...pdf). Pavarësisht sa më sipër, GVJ sugjeron uljen e numrit të lëndëve dhe të ngarkesës për disa pedagogë të programit, që rezulton deri në 5 lëndë të ndryshme, kur mbajnë edhe funksione administrative përvec mësimdhënies.</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e përsonelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë përiudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</td>
<td>GVJ duke u mbështetur në dokumentacionin e DVV si dhe atë të siguruar gjatë vizitës në institucion, konstaton se për tri vite, përgjithësisht nuk ka qarkullim stafi apo largime të stafit, por vihet re shtim i stafit akademik, kryesisht seminaristë pa titull/gradë shkencore. Referuar listëpagesave në DVV si dhe vizitës në institucion, në dosjet e stafit, rezultojnë kontratat e punësimit për stafin akademik si dhe atë joakademik.<br><br>Evidenca nr. 89. Lista e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit në 2 vitet e fundit Ba. Informatikë Ekonomike.pdf<br><br>Evidenca nr. 69. Listpagesa e IAL per vitim 2024.pdf<br><br>Evidenca nr. 70. Kontrate pune TIP e pedagogut (i brendshem-jashtëm).pdf<br><br>Tabelat përmbledhëse për stafin akademik të departamentit dhe stafit në programin - Informatikë Ekonomike...pdf (dokumenta shtesë, pas vizitës në institucion)</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e përsonelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsultoi praktika rekrutimi të cilat, mbështeten në procedura rekrutimi dhe vlerësimi, me kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Kriteret si dhe nevojat propozohen nga Departamenti, Dekani i cili i përcjell kërkesën rektorit. Rektori e përcjell kërkesën e fakulteteve senatit për miratim final të kuotave dhe kritereve përzgjedhëse. Në vijim ato publikohen në webin e institucionit, kur vihet re se janë publikuar njoftime rekrutimi, kriteret si dhe data dhe ora e intervistës. Vlerësimi bëhet mbi procedura të ndara në dy faza, vlerësimi i dosjes dhe intervista. Komisioni miratohet nga rektori. Referuar praktikës së vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se komisioni ad-hoc i propozon dekanit listen për rekrutim të renditura sipas pikëzimit, së bashku me vlerësimin për secilin. Komisioni propozon renditjen përfundimtare të kandidatëve dhe miratimi bëhet nga rektori. Kontrata lidhet mes fituesit dhe Kryetarit te Bordit te Administrimit.<br><br>*74. Praktike e ZBNJ per rekrutim stafi akademik ne IAL.pdf*<br><br>*Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 11. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore.pdf*<br><br>*2. Praktike rekrutimi per staf akademik me kohe te plote.pdf (vizita ne institucion)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, nga takimi me stafin e programit dhe studentët, dhe nga konsultimi i organogramës së institucionit, rezulton se institucioni garanton staf ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike të programit, apo të mbështetjes së studentëve gjatë procesit të shkrimit të temave të diplomës. Stafi akademik mbështetës rezulton i angazhuar dhe i motivuar, për të orientuar dhe mbështetur studentët gjatë orëve laboratorike që për shkak të natyrës teknike që ka programi dhe lëndëve që përmban ai, orët laboartorike si komponent i rëndësishëm, të realizohen në mënyrë të suksseshme.<br><br>*Evidenca nr. 66. Organigrama e IAL..pdf* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e përsonelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave përsonale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e | Referuar dosjes së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" si dhe DVV, GVJ pati në dispozicion informacion për stafin akademik efektiv dhe joefektiv të tre viteve të fundit, ngarkesa e tyre sipas semestrave, lëndët që mbulojnë, Cv-të e tyre si dhe në zyrën e burimeve njerëzore u konsultua informacion dhe i dosjeve të tyre, kualifikimet akademike, kontratat, Cv-të, Librezat e punës etj.<br><br>Për sa më sipër GVJ është e mendimit që informacioni i kërkuar në këtë kriter është i plotë. |

| | |
|---|---|
| përsonelit akademik të përfshirë në program dhe të përsonit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të përsonelit ndihmës dhe administrativ. | *Evidenca nr. 36. Formati i dosjes përsonale të stafit akademik dhe Kontrata TIP e punësimit të pedagogut.pdf*<br><br>*CV-të e stafit akademik të programit të studimit. pdf*<br><br>*Evidenca nr. 21. Stafi akademik i Njesise Baze - Dep. Finances - 2023-2024.pdf* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion përsonelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Referuar numrit të vogël të studentëve si dhe marrëveshjeve që Kolegji Universitar "Reald" disponon me kompani dhe institucione në qytetin e Vlorës, GVJ është e mendimit se ky kolegj, nëpërmjet stafit të vet akademik dhe jo akademik, si dhe mentorëve në biznes, ka kapacitetet për udhëheqjen e studentëve në praktikë si dhe në punimin e diplomës.<br><br>GVJ vë re nga dokumentacioni si dhe nga vizita në institucion se Kolegji Universitar "Reald", disponon marrëveshje, si me Portin Detar, Posten Shqipatre etj, per te realizuar praktikat mesimore.<br><br>Institucioni rezulton se bën analiza për përfitimet e programit dhe të studentëve nga këto marrëeshje.<br><br>*14. Plani Mesimor - Bachelor në Informatikë Ekonomike.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 27. Disa nga marreveshjet e bashkepunimit aktive me aktoret e biznesit per kryerjen e praktikes mesimore..pdf*<br><br>*Evidenca nr. 28. Raport periodik analitik për kryerjen e praktikës mësimore të studentëve.pdf* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | GVJ konstaton se, marrëveshjet mes Kolegjit Universitar "Reald" dhe institucioneve/kompanive kanë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve më potenciale për mbikëqyrjen e studentëve në praktika mësimore. Institucionet marrin përsipër të vendosin në dispocion mjediset e tyre si dhe mentorë për udhëheqjen/mentorimin e studentëve të programit të studimit "Informatikë Ekonomike". KUR ndjek me stafin akademik ecurinë e studentëve në praktika duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me mentorët në biznese si dhe me studentët.<br><br>*Evidenca nr. 27. Disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit aktiv me aktorët e biznesit për kryerjen e praktikës mësimore.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 28. Raport përiodik analitik për kryerjen e praktikës mësimore të studentëve.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ, duke u mbështetur në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe në vizitën në Kolegjin Universitar "Reald", vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit Bachelor n.ë "Informatikë Ekonomike" përmbush standardet sasiore. Pavarësisht rritjes së numrit* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *të stafit akademik gjatë vitit të fundit, GVJ, duke marrë parasysh numrin e lëndëve dhe përbërjen aktuale të stafit të angazhuar, rekomandon zgjerimin e trupës akademike me pedagogë që mbajnë tituj dhe grada shkencore, pasi aktualisht 50% e stafit efektiv përbëhet nga "asistentë lektorë".*<br><br>*Gjithashtu, GVJ sugjeron reduktimin e numrit të lëndëve dhe të ngarkesës akademike për disa pedagogë të programit, të cilët aktualisht mbulojnë deri në pesë lëndë të ndryshme, krahas detyrave administrative që ushtrojnë paralelisht me mësimdhënien. Për këtë arsye, GVJ rekomandon optimizimin e ngarkesës së tyre brenda institucionit, me qëllim rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe efikasitetit akademik.*<br><br>*Institucioni ndjek praktika të qarta dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e stafit, të cilat mbështeten në rregulloren e brendshme të institucionit* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | **X** | | |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ duke konsultuar dokumentacionin për infrastrukturën si dhe nga vizita në mjediset e KUR, konstaton se mjediset janë të përshatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve. KUR rezulton se e zhvillon veprimtarinë e vet në dy godina, A me sipërfaqe 3066 m^2, e shtrirë në tre kate dhe B me sipërfaqe 2600 m^2. Godinat janë strukturuar në salla leksionesh, seminaresh, zyra, laboratore, mjedise shlodhëse etj. Godina A rezulton të ketë 17 salla leksionesh dhe seminaresh, 1 sallë konference si dhe 7 laboratore dhe kabinete profesionale sipas programeve të studimit. Biblioteka, sekretaria, zyrat si dhe ambjentet shlodhse janë në këtë godinë.<br><br>*Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura | Referuar vizitës në institucion, konstatohen se klasat dhe laboratorët janë me kapacitete të mjaftueshme, përgjithësisht rezultonin të pajisura me videoprojektorë, white board, PC dhe si rrjet kabllor internet, që |

| | |
|---|---|
| me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.<br><br>*Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Gjatë vizitës në institucion, në mjediset e KUR, rezulton se sallat e leksioneve dhe seminareve, si dhe laboratorët, kanë pajisjet e teknologjisë së informacionit, kompjutera dhe softet që i shërbejnë plotesimit të objektivave të programit, për realizimin e detyrave, prezantimeve audiovizive apo për përpunimet kompjuterike, në përputhje me natyrën e lëndëve të programit të studimit bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Biblioteka gjithashtu rezulton me pajisur me 20 kompjutera.<br><br>*Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf*<br><br>*Evidenca 35. Laboratori i Informatikës ne IAL.pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Referuar evidencës infrastrukturore, rezultojnë shtatë laboratorë ose kabinete në dispozicion, të cilët kryesisht shërbejnë për programet e studimit në shkencat e jetës. Për programet e studimit me profil ekonomik, Kolegji Universitar "Reald" vë në dispozicion një laborator informatike, i cili, sipas vizitës në institucion dhe evidencës nr. 35, përfaqëson një investim bashkëkohor. Ky laborator është i pajisur me 48 kompjuterë të gjeneratave më të fundit dhe softuerë aplikativë që janë në përputhje me kërkesat akademike të lëndëve të programit.<br><br>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se laboratorët janë të pajisur me teknologjinë e informacionit, duke përfshirë kompjuterë dhe softuerë që përputhen me natyrën e lëndëve specifike të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Këto ambiente mbështesin zhvillimin e lëndëve me karakter teknik brenda këtij programi studimi.<br><br>*Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf*<br><br>*Evidenca 35. Laboratori i Informatikës ne IAL.pdf*<br><br>*38. Rack-u i lidhjes në rrjet ne IAL.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se KUR vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, si dhe për formimin praktik të studentëve të këtij programi. Këto mjedise* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *garantojnë kapacitetet e duhura fizike, laboratorike, softuerike dhe me pajisjet e duhura për procese mësimdhënëse cilësore.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3** | |
|---|---|
| **IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | GVJ konsultoi syllabuset e lëndëve, vizitoi bibliotekën e institucionit si dhe komunikoi me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion nga ku rezulton se në dispozicion të studentëve është vendosur literatura bazë dhe ndihmuese në shërbim të njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Kjo literaturë është në gjuhën shqipe dhe angleze. Burimet e saj gjenden fizikisht si dhe në bibliotekat elektronike qe institucioni ka mundësuar.<br><br>*Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 18. Syllabuset – pdf* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Referuar dosjes së vetëvlerësimit rezulton se literatura në programet e lëndëve është kryesisht në gjuhën shqipe në përputhje me përmbajtjen e syllabusit të lëndës.<br><br>*GVJ sugjeron që departamenti të azhornojë literaturën në syllabuse sipas kërkesave të VKM 41 të ndryshuar e të vijojë me kërkesat edhe për azhornimin e bibliotekës me këto tituj më të fundit.* Biblioteka pasurohet në vijueshmëri.<br><br>*Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 18. Syllabuset – pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të | KUR vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Kjo bibliotekë është në shërbim për studentët e të gjitha njësive kryesore që IAL ka. Referuar Evidencave për infrastrukturën e KUR, biblioteka është e pajisur me softe dhe me 20 PC.<br><br>Biblioteka ka një orar të përshtatshëm që siguron shfrytëzim të mirë nga studentët e programit nga e hëna në të shtunë, 08.00-16.00. |

| | |
|---|---|
| barabartë nga studentët e programit të studimit. | *Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Duke iu referuar fondit të librit si dhe kapacitetit të bibliotekës rezulton se ajo është e pajisur me fond fizik librash në mbështetje të programit të studimit bachelor në IE, si literaturë bazë dhe ndihmëse dhe revista shkencore në periodikë të fushave të ndryshme.<br><br>Në këtë fond të literaturës, janë librat bazë për lëndët e PS bachelor në IE, si dhe literatura ndihmëse, shqip ose anglisht, sipas programit të lëndëve. *Pavarësisht kësaj është e nevojshme azhornimi i bibliotekës me literaturë fizike të përditësuar për IE, të viteve të fundit, duke konsideruar dhe ritmet e zhvillimit të kësaj fushe si dhe pasqyrimit të këtij ritmi zhvillimi në literaturë.*<br><br>Lista e librave mund të konsultohet online nëpërmjet webit të institucionit. GVJ nuk konstatoi nga dokumentacioni dhe as nga vizita në institucion mundësi shfrytëzimi të bibliotekave elektronike.<br><br>*Për sa më sipër, GVJ sugjeron që institucioni të mundesojë regjistrimin në biblioteka elektronike si U-Library, Jstor apo të tjera, si mundësi për stafin akademik dhe studentët, për të pasur në dispozicion më shumë tiutuj se çfarë mund të ketë biblioteka fizike e për më tepër titujt më bashkëkohor si mundësi për hulumtimet e materialeve sidomos për lëndët teknike, karakterizuese të programit të studimit Informatikë Ekonomike", si dhe për zhvillimin e temës së diplomës.*<br><br>*Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Biblioteka ofron kushte për shfrytëzim dhe akses të barabartë të fondit fizik dhe pa pagesë për studentët e kësaj njësie kryesore. Nga vizita në institucion rezulton se mjediset e bibliotekës janë në dispozicion të studentëve jo vetëm për shfrytëzimin e fondit të librit, por edhe si sallë studimi gjatë semestrit apo sezoneve të provimeve.<br><br>*Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Referuar evidencës infrastrukturore të bibliotekës si dhe vizitës në institucion salla e bibliotekës është e pajisur me 20 PC dhe disa pajisje të tjera si skaner e fotokopje. Studentët mund të përdorin dhe katalogun elektronik të bibliotekës.<br><br>*Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf* |

| | |
|---|---|
| | |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, biblioteka funksionon në orare zyrtare 08-16.00, nga e hëna në të shtunë në shërbim të studentëve dhe stafit akademik. Mësimi në programin e studimit bachelor në "Informatikë Ekonomike", zhvillohet nga e hëna në të premte, ndërkohë që orari i bibliotekës është më i shtrirë në kohë dhe krijon mundësi shfrytëzimi të mirë nga studentët e këtij programi.<br><br>*Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga përsoneli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për përformancën e përsonelit akademik. | GVJ konstatoi në dosjen e vetëvleresimit të bachelor në "Informatikë Ekonomike" se funksionimi i bibliotekës, pasurimi i saj dhe cilësia e fondit të librit është pjesë e analizës vjetore të institucionit.<br><br>*Pavarësisht për sa më sipër, GVJ sugjeron shtimin e fondit fizik të librit në gjuhën shqipe dhe përditësimin e saj, në përputhje me programin e studimit dhe sugjeron që kërkesat për libra të bëhen periodikisht nga stafi i departamentit si dhe të kenë një fond të parashikuar në buxhet për pasurimin e përvitshëm të bibliotekës.*<br><br>*Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se kushtet fizike infrastrukturore të bibliotekës së KUR, janë të përshtatshme për t'ju shërbyer kapaciteteve dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. GVJ sugjeron shtimin e fondit fizik dhe regjistrimin në biblioteka elektronike të aksesueshme nga stafi dhe studentët. GVJ sugjeron pasurimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet e bashkëkohore të titujve në përputhje me programin e studimit bachelor në "Informatikë Ekonomike".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Referuar RVB, vizitës në sekretarinë mesimore si dhe Evidencave të DVV, GVJ konstaton se KUR disponon një Sistem të Manaxhimit të Informacionit, SMI, që siguron akses për këta përdorues: studentët, stafin akademik, sekretaritë si dhe zyrën e IT. Sistemi i Manaxhimit të informacionit SMI, është një sistem elektronik, që administron informacionin nga regjistrimi deri në dalje, për studentët e programit.<br><br>Përveç dokumentacionit letër të disponueshëm ne zyrat e KUR, ky sistem elektronik i manaxhimit te informacionit, krijon mundësi aksesi në informacionin e vlerësimit të studentëve, akses për studentet, stafin akademik dhe zyrat mbështetëse të institucionit. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, përsonelit ndihmësakademik, përsonelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | GVJ konstaton se përveç sistemit elektronik SMI, për stafin dhe studentët informacioni mbahet edhe në formë shkresore. Për studentët informacioni përveçse në sistem, rezulton i ruajtuar edhe nëpërmjet regjistrit themeltar, regjistrit të përparimit akademik të studentëve, si dhe regjistrit të lëshimit të diplomave. Këto regjistra u konsultuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion dhe rezultuan me informacion e plotë të kërkuar.<br><br>*Evidenca nr. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf*<br><br>*94. Rregullore e Sistemi te Menaxhimit te Informacionit - SMI.pdf*<br><br>*64. Regjistri i rezultateve te studenteve - Kapaku.pdf* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë përsonelin dhe studentët e programit të studimit. | Referuar përdorimit të sistemit, GVJ konstatoi se sistemi SMI, ka hapësirën virtuale të çdo pedagogu/lënde, për komunikim interaktiv me studentët. Përveç sistemit, institucioni për komunikim interaktiv dhe zhvillim të mësimit online ka përdorur platforma elektronike si Google Meet etj<br><br>*94. Rregullore e Sistemi te Menaxhimit te Informacionit - SMI.pdf* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet përsonelit akademik dhe studentëve. | GVJ nga vizita në sekretarinë e KUR, dhe konsultimit të dokumentacionit konstaton se përveç formës shkresore të ruajtjes së informacionit në regjistra, institucioni ka sistemin elektronik SMI që u demostrua për GVJ dhe që me kapacitetin që ka, mendojmë se ndihmon të ofrojë në mënyrë efektive dhe koherente informacion për studentët dhe vlerësimet e tyre, procesverbalet e lëndëve të ndryshme, mundësi komunikimi interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, lehtësi në manaxhimin e informacionit për sekretaritë etj. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Sistemi menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Përdoruesit e sistemit rezultojnë të kenë akses të dedikuar në sistem nëpëmjet kredencialeve të tyre përsonale, nga vizita në institucion rezultoi se stafi akademik informon studentët për rezultatet, nëpërmjet sistemit, studentët informohen në kohë reale për to.<br><br>Sistemi elektronik i informacionit SMI, rezulton një sistem i integruar me platforma dhe module që suportojnë komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, duke e bërë komunikimin mes tyre më efektiv. *Pavaresisht potencialit që sistemi ka, GVJ sugjeron që institucioni të sensibilizojë studentët kryesisht, por edhe stafin akademik për përdorimin e sistemit dhe minimizimin e formave tradicionale të komunikimit me studentët, të notave, ankimimeve apo informacioneve të tjera, dhe përforcimin rutinor të përdorimit të sistemit prej tyre.*<br><br>*94. Rregullore e Sistemi te Menaxhimit te Informacionit - SMI.pdf* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | KUR ka një faqe interneti me informacion të përmbledhur për të gjitha njësitë kryesore, si dhe informacion që lidhen me programin e studimit, përsonelin akademik, aktivitetet e ndryshme të njësive të tjera. Faqja zyrtare është në tre gjuhë: shqip, italisht dhe anglisht.<br><br>Në faqen zyrtare ofrohet mundësi aksesi për përdoruesit e brendshëm me anë të kredencialeve përsonale.<br><br>*Evidenca nr. 39. Të dhëna nga faqja WEB.pdf* |
| **Konkluzione** | ***GVJ konstaton se Kolegji Reald, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, KUR, harton një raport vjetor. Referuar DVV, pjesë e këtij raporti rezulton të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon për miratim në bordin e Administrimit. GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar një raport të analizës së kostove të programeve të studimit, ku paraqet informacionin për zërat e kostove dhe nivelet e tyre, ku 50% e tyre e zënë shpenzimet e pagave. Në këtë raport konstatohen edhe strategjitë për financimin e këtyre shpenzimeve.<br>*41. Kosto e programit të studimit Ba. Informatike Ekonomike.pdf*<br>*69. Listpagesa e IAL per vitim 2024.pdf* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Referuar RVB dhe DVV, rezulton se raporti financiar paraqet informacion për zërat që do të financohen dhe nga çfarë burimesh financohen, politika e pagave, politika e bursave të meritës apo bursave sociale që KUR ndjek etj. Në raport jepen shpenzimet e planifikuara për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për këshillat studentore etj.<br>*Evidenca nr. 75. Vendim i BA për trajtimin e studenteve me status të veçantë dhe miratimin e bursave..pdf*<br>*52. Vendim Bordi nr. 7. Viti 2024- Per miratim fondi per Keshillin Studentor 2024-2025.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim përiodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | GVJ referuar RVB dhe DVV, konstaton se raporti për buxhetin dhe realizimin e tij është i detajuar deri në nivel njësie bazë përgjegjëse.<br>Ne këtë raport pasqyrohen zërat e shpenzimeve, nivelet e tyre, të ardhurat dhe burimet e tyre.<br>Konstatohen në këtë raport zëra të financimit të mbështetjes studentore, për bursa ose për keshillat studentore.<br>*88. Raporti vjetor 2022-2023 dhe shkresa percjellese ne MAS.pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Referuar RVB si dhe DVV, rezulton se KUR i siguron të ardhurat nga tarifat e studentëve.<br><br>Gjithashtu GVJ konsultoi edhe listëpagesat për stafin, çfarë demostron aftësinë për të paguar deyrimet ndaj stafit të institucionit.<br><br>*Pavarësisht sa më sipër, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve, GVJ sugjeron, se KUR duhet të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare etj.*<br><br>*69. Listpagesa e IAL per vitim 2024.pdf*<br><br>*68. Listë-pagesa e IAL per vitin 2023.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se KUR, harton dhe miraton buxhete vjetore si dhe raporton realizimin e tij dhe raporton e analizon kostot e programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje | GVJ konstaton se KUR ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë të Bachelor në "Informatike Ekonomike", nga hyrja deri në diplomim të studentëve në Bachelor në "Informatike Ekonomike". Këto procedura janë të sanksionuara respektivisht në *nenin 37-73* të rregullores së |

| | |
|---|---|
| me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | institucionit, si dhe në Strategjinë e zhvillimit të KUR, ku ndër objektivat e kësaj strategjie gjenden edhe objektivat specifikë për mesimdhenien dhe mësimnxënien me në qendër studentin. (pika 7 e strategjisë)<br>*Evidenca nr. 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 - 2026.pdf*<br>*Evidenca nr. 5. Rregullore e përgjithshme e IAL - e ndryshuar.pdf*<br>*7. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve - 2018.pdf* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton se dokumentet strategjike të KUR, si strategjia e institucionit *pika 7*, rregullore e institucionit, rregullore e fakultetit *neni 44*, rregullore e programit, fokusohen në trajtimin e barabartë dhe sipas meritokracisë, referuar procedurave të përzgjedhjes së studentëve si dhe atyre të vlerësimit të avancimit akademik të tyre.<br>*Evidenca nr. 6. Rregullore e njësisë kryesore FE.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Referuar takimeve me drejtues së njësisë kryesore dhe asaj bazë, webit zyrtar si dhe DVV, rezulton se institucioni publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithëshme që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u pranuar në Bachelor në Ïnformatike Ekonomike". Këto kritere miratohen nga senati akademik dhe publikohen në faqen zyrtare.<br>Referuar vendimit të senatit për kriteret e vitit akademik 2022-2023 dhe 2023-2024, aksesuar nga GVJ në faqen zyrtare të internetit, rezulton se kriteret janë vetëm kritere të përgjithshme dhe konkretisht nota mesatare e shkollës së mesme, sipas bazës ligjore.<br>Linku ne vijim : Kriteret e Pranimit - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)<br>*(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al))* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e pranimit së studentëve janë të publikuara në webin zyrtar të KUR dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit. Informacioni në web ofrohet edhe për mundësitë e përfitimit të bursës, transferimet, oraret mësimore si dhe për kalendarin e provimeve. Informacioni në web për studentet është i plotë dhe jepet në tri gjuhë: shqip, italisht dhe anglisht. Më poshtë linqet e konsultura nga GVJ për këtë kriter.<br>*(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al ; Kohëzgjatja e studimeve - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al); Mbrojtja e diplomës - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al); Transferime dhe ekuivalentime - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al))* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | GVJ duke iu referuar DVV si dhe webit të instituconit, konstaton se Kolegji Universitar Reald, realizon informimin e publikut për kërkesat e pranimit në Bachelor në "Informatike Ekonomike", nëpërmjet webit të institucionit, ku publikohen vendimet e senatit akademik të institucionit rreth kritereve të pranimit. Institucioni sensibilizon publikun edhe për mundësinë e përfitimit të bursës së meritës apo për shtresa të margjinalizuara.<br><br>*(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al)* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Referuar dokumentacionit si dhe takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS bachelor në "Informatike Ekonomike", të cilat miratohen nga senati akademik si dhe nga bordi i administrimit dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përcaktimi i kritereve për shtresat e margjinalizuara si dhe për kandidatët nga shtete të tjera, mbështeten në udhëzimet e MAS.<br><br>Për sa më sipër, GVJ konsultoi webin e institucionit dhe konstaton se institucioni i publikon në faqen zyrtare, kriteret për pranimin në programet e studimit.<br><br>*(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al)* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Referuar njoftimeve në faqen zyrtare të institucionit, rezulton se kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera si dhe kuotat për ta janë hartuar në përputhje me udhëzimin e MAS nga departamenti, janë miratuar nga senati akademik dhe bordi i administrimit i KUR, si dhe janë publikuar për informim të gjerë të palëve të interesuara. Fokusi i këtyre kritereve, vendoset tek mesatarja e shkollës së mesme.<br><br>*(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al)* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Referuar faqes zyrtare të internetit të institucionit si dhe DVV, GVJ konstaton se institucioni ofron informacion të plotë për përfitimin e bursave, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Këto bursa parqiten si bursa merite ose bursa financiare apo përjashtim nga pagesat e tarifave për shtresat në nevojë në përputhje me vendimet qe Bordi i Administrimit merr. Në DVV insitucioni vendos në dispozicion edhe vendime të BOA për bursat. Në këtë vendim GVJ konstaton se për 2022-23, bursat janë 100% për studentët ekselentë me mesatare 10 dhe 50% bursë për studentët e komunitetit romë-egjyptian apo që janë me aftësi ndryshe.<br><br>*Evidenca nr. 75. Vendim i BA për trajtimin e studentëve me status të veçantë dhe miratimin e bursave..pdf* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ, mbështetur në dokumentacion në DVV si dhe nga vizita në institucion, është e mendimit se institucioni, harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në "Informatike Ekonomike". Këto gjenden në rregulloren e institucionit, të fakultetit, të programit si dhe ato publikohen e janë të aksesueshme në web e institucionit në tre gjuhë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Nga vizita në institucion si dhe nga DVV, GVJ konstaton se KUR ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e institucionit *neni 42*, të njësisë kryesore si dhe të programit bachelor në "Informatike Ekonomike". GVJ vlerëson se ky informim bëhet në forma alternative, nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet zyrës së kvshillimit si dhe nëpërmjet webit të fakultetit.<br><br>*Evidenca nr. 7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 6. Rregullore e njësisë kryesore FE.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 5. Rregullore e përgjithshme e IAL - e ndryshuar.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ konstatoi se KUR në faqen zyrtare publikon kriteret për transferimet për informim të gjerë, gjithashtu nga takimi me studentët rezulton se informohen parimisht nëpërmjet akteve të cituara në kriterin më sipër dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit, por ata preferonin më tepër informimin fizikisht, nëpërmjet zyrës së këshillimit dhe karrierës, sekretarisë mësimore dhe departamentit të Financës. |

| | |
|---|---|
| | *Transferime dhe ekuivalentime - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Referuar DVV, por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin e programit, GVJ konstaton nga takimet me stafin dhe studentët, se ata informohen nga pedagogët e çdo lënde në orën e parë të semestrit për syllabuset, detyrimet lëndore, kriteret e vlerësimit, etj. këto kritere janë pjesë të rregullores së institucionit dhe të rregullores së programit që gjithashtu rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të IAL. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Për GVJ rezulton se informimi për punimin e diplomës bëhet nga udhëheqësit e studentëve dhe nëpërmjet Udhëzuesit të punimit të diplomës si dhe nëpërmjet sekretarive për afatet dhe detyrimet që duhen përmbushur para diplomimit. Përvec kesaj, institucioni ka rregulluar me akt të posaçëm regulativ procesin e diplomimit dhe informon studentet nepërmjet webit si dhe stafit akademik apo administrativ për detyrimet që kanë sipas kësaj rregulloreje të diplomimit.<br><br>*Evidenca nr. 46. Udhëzuesi për punimin e temës së diplomës.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 10. Rregullore e Diplomimit të Studentëve.pdf* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Rezulton nga DVV se institucioni organizon ditë informuese dhe orientuese për student të ardhshëm të programit në shkollat e mesme kryesisht të qytetit të Vlorës. Të interesuarit infomohen edhe me anë të mesazheve promocionale që jepen në mediat lokale si dhe nepërmjet shpërndarjes së posterave.<br><br>*Evidenca nr. 39. Të dhëna nga faqja WEB.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 40. Poster për informimin e publikimit te informacionit për programet qe ofron IAL.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se institucioni ofron mundësi informimi për studentët për kriteret e vlerësimit, kuotat, transferimet, për detyrimet lëndore, për punimin e temës së diplomës si dhe informim për studentët e ardhshëm.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | GVJ konstatoi se institucioni informon studentët me informacion të plotë lidhur me programin. Ky informacion konsiston, në kohëzgjatjen e programit, strukturën e çdo semestri, formën e organizimit, detyrimet që studentët kanë etj.<br><br>GVJ konstatoi se ky informim realizohet nga departamenti dhe stafi akadamik nepërmjet syllabuseve, strukturat e sekretarisë mësimore si dhe zyra e Këshillimit dhe Karrierës për orarin mesimor si dhe për kalendarin e provimeve etj. Studentët rezulton se informohen gjithashtu në distancë nëpërmjet faqes zyrtare, videove promovuese dhe broshurave që paraqesin informacion për programin e studimit bachelor ne "Informatike Ekonomike".<br><br>*Evidenca nr. 59. Kalendari i zhvillimit të provimeve.pdf*<br><br>*18. Syllabuset - Viti III..pdf*<br><br>*Evidenca nr. 58. Orari mësimor.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | GVJ konstaton se gjatë takimeve me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit dhe studentët e PS në Bachelor në Informatike Ekonomike", se çdo pedagog gjatë javës së parë të çdo viti, informon në mënyrë specifike për studentët për lëndën, syllabusin, literaturën dhe detyrimet akademike të çdo lënde, format dhe skemat e vlerësimit që janë të sanksionuara në rregullore dhe në syllabuse, etj<br><br>*18. Syllabuset - Viti III..pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Nga takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, u konstatua se kjo zyrë zhvillon aktivitete për orientimin e studentëve në tregun e punës, megjithatë, deri më tani, këto aktivitete kanë qenë të kufizuara dhe sporadike.<br><br>*GVJ rekomandon që veprimtaria e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit të jetë më e strukturuar, më e dukshme dhe më e vazhdueshme. Aktivitetet e saj duhet të jenë të përshtatura me nevojat e studentëve sipas programeve të studimit, duke ofruar një mbështetje më të qëndrueshme institucionale për orientimin dhe integrimin e tyre në tregun e punës.*<br><br>*Evidenca nr. 24. Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve.pdf* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentët janë të mirëinformuar në lidhje me procesin mësimor, lëndët, programet e studimit, format e vlerësimit dhe infrastrukturën në dispozicion të tyre.<br><br>Gjithashtu, u konstatua se institucioni organizon rregullisht ditë të hapura për studentët e rinj, bazuar në një kalendar informues. Këto aktivitete nuk kufizohen vetëm në procesin mësimor, por përfshijnë gjithashtu prezantimin e shërbimeve të ofruara nga zyrat mbështetëse dhe aktivitete të tjera studentore. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se sistemi elektronik ofron akses të gjerë në informacion mbi procesin mësimor, duke përfshirë syllabuset, leksionet e parashkruara, prezantimet në PowerPoint të disponueshme në hapësirën e pedagogut, detyrimet lëndore, oraret e mësimit, kalendarin e provimeve dhe vlerësimin e çdo lënde.<br><br>Gjithashtu, për studentët e ardhshëm dhe publikun e gjerë, një pjesë thelbësore e këtij informacioni ofrohet edhe përmes faqes zyrtare të institucionit, e cila është e disponueshme në tre gjuhë: shqip, italisht dhe anglisht.<br><br>*home - Collegio Universitario REALD (unireald.edu.al)* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se institucioni siguron informacion të qartë mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit, si dhe mbi rezultatet e pritshme të të nxënit. Ky informacion ofrohet përmes sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe faqes zyrtare të internetit, e cila është e disponueshme në tri gjuhë.*<br><br>*Megjithatë, GVJ rekomandon që institucioni të rrisë efektivitetin e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, duke forcuar aktivitetet e saj në funksion të orientimit të studentëve dhe rritjes së mundësive të tyre për punësim.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe me sekretarinë, konstaton se KUR harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS Bachelor në "Informatikë Ekonomike".<br><br>Referuar regjistrave themeltar nga vizita në institucion si dhe Evidences 23, rezulton se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik është:<br><br>2022-2023 7 studentë;<br><br>2023-2024 21 studentë;<br><br>2024-2025 21 studentë.<br><br>*23. Te dhena per nr. studenteve te regjistruar sipas viteve akademike 2022-2024..pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | GVJ, duke iu referuar të dhënave dhe regjistrave të mbajtur nga institucioni, konstaton se KUR siguron një ndjekje të vazhdueshme të ecurisë akademike të studentëve deri në diplomim. Institucioni regjistron vlerësimet e studentëve në çdo lëndë, duke ruajtur këto të dhëna si në procesverbalet analitike të çdo lënde në format fizik (hard copy), ashtu edhe në regjistrat themeltarë, ku çdo student rezulton i regjistruar dhe është pajisur me një numër unik matrikulimi.<br><br>Gjithashtu, GVJ shqyrtoi dosjet e studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e kërkuar dhe të noterizuar, përfshirë diplomën e shkollës së mesme, listën e notave, fotokopjen e kartës së identitetit, mandatet e pagesës dhe dokumente të tjera përkatëse.<br><br>*23. Te dhena per nr. studenteve te regjistruar sipas viteve akademike 2022-2024..pdf* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga përsonat e autorizuar. | GVJ konstatoi se të dhënat për studentët, përfshirë regjistrimet, vlerësimet e çdo lënde dhe detyrimet akademike, ruhen manualisht në sekretarinë e KUR, si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e informacionit nga sekretaria, në përputhje me procedurat e parashikuara për këtë sistem.<br><br>GVJ vlerëson pozitivisht këtë qasje të kombinuar të mbajtjes së të dhënave, si në format fizik ashtu edhe elektronik, pasi ajo rrit sigurinë e ruajtjes së të dhënave dhe përmirëson shpejtësinë e aksesit në informacion nga përdoruesit e autorizuar të sistemit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin përiodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për Financëin (sekretaritë mësimore, sistemin | GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, konstatoi se proceset mbikëqyrëse dhe strukturat që mbajnë përgjegjësinë për realizimin e këtyre proceseve, si dhe për monitorimin e tyre, janë të përcaktuara dhe të sanksionuara në rregulloren e institucionit. Këto përgjegjësi kryhen nga strukturat e departamentit ose fakultetit. |

| | |
|---|---|
| e Financëit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | *23. Te dhena per nr. studenteve te regjistruar sipas viteve akademike 2022-2024..pdf*<br><br>*Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD.pdf* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | KUR disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit, duke përfshirë mesataren në hyrje dhe në dalje, dhe i analizon ato në kuadër të analizave vjetore. GVJ, duke u mbështetur në DVV, konstatoi se këto të dhëna përfshihen në analizën e departamentit dhe raportin vjetor të institucionit, të cilat shoqërohen me plan masash për përmirësim.<br><br>GVJ sugjeron që institucioni të intensifikojë përpjekjet për të rritur numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".<br><br>*Evidenca nr. 31. Analizë e Departamentit për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.pdf*<br><br>*88. Raporti vjetor 2022-2023 dhe shkresa percjellese ne MAS.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon se institucioni administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", nga pranimi deri në diplomim.*<br><br>*GVJ sugjeron, që institucioni duhet të intensifikojë përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit bachelor në "Informatikë Ekonomike" si dhe të cilësisë së tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | E drejta për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese është e përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 dhe në Statutin e KUR, nenin 10. GVJ konstatoi, duke u mbështetur në RVB dhe informacionin e siguruar nga DVV, se studentët janë të përfaqësuar në njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm institucional dhe në GVB.<br><br>Po ashtu, studentët kanë krijuar këshillat studentore, të cilat mbështeten nga institucioni me financim dhe infrastrukturë, per te mbeshtetur funksionimin e tyre.<br><br>*Sidoqoftë, pas takimeve me studentët, GVJ sugjeron që institucioni të nxisë një angazhim më proaktiv dhe të qëndrueshëm të tyre në këto struktura vendimmarrëse. Ky angazhim mund të kontribuonte në forcimin e përfaqësimit të studentëve dhe në rritjen e ndikimit të tyre në proceset vendimmarrëse të institucioni. Gjithashtu, angazhimi më aktiv i studentëve mund të ndihmonte në identifikimin e nevojave të tyre dhe përmirësimin e proceset akademike dhe administrative.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Sipas dosjes së vetëvlerësimit, studentët janë pjesë e komisioneve të vetëvlerësimit institucional dhe programor. Pjesëmarrja e tyre në këto procese të vlerësimit të brendshëm krijon mundësinë që ata të shprehin perceptimet e tyre dhe të ofrojnë sugjerime lidhur me proceset mësimore, funksionimin e strukturave të institucionit dhe aspekte të tjera të rëndësishme.<br><br>Nga takimi me studentët, u konstatua se ata shprehin mendimet e tyre gjithashtu përmes pjesëmarrjes në anketat që zhvillohen çdo semestër për vlerësimin e procesit akademik dhe të infrastrukturës së institucionit.<br><br>*Evidenca nr. 32. Pyetesori i studenteve.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 48. Pyetesor qe plotesohet nga studentet, për kushtet ne IAL.pdf* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në | Nga takimi me drejtues të njësisë bazë, rezultoi se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit mësimor në Bachelor në "Informatike Ekonomike", është indirekt nëpërmjet feedbackut që njësia bazë merr prej pyetësorit të studentëve që zhvillohen dy herë në vit nga NJSBC, si dhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në GVB.<br><br>GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor.<br><br>*Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf* |

| | |
|---|---|
| departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | *56. Urdher i dekanit per ngritjen e GVB ne programin Ba. Informatike Ekonomike.pdf* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | GVJ konstaton se rregullorja e institucionit ka sanksionuar të drejtat e studentëve për ankimimin e rezultateve të vlerësimit dhe për rishikimin e tyre. Sipas informacionit të siguruar nga takimet me stafin akademik dhe studentët, studentët kanë mundësinë për të ankimuar rezultatet e vlerësimit, si dhe për të konsultuar tezën e provimit. Pas kësaj, pedagogu i lëndës është përgjegjës për përcaktimin e notës përfundimtare. Në rast se studenti vazhdon të ketë kundërshtime për rezultatin, ai mund të drejtohet me shkrim te përgjegjësi i departamentit, i cili merr masat për ngritjen e një komisioni të ri për rishikimin e rezultatit.<br><br>Gjithashtu, GVJ konstaton se, përmes anketimeve semestrale, studentët kanë mundësinë të shprehin perceptimet e tyre në lidhje me barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.<br><br>*Evidenca nr. 32. Pyetësori i studentëve.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 48. Pyetësor që plotesohet nga studentët, për kushtet në IAL.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se studentët janë të përfaqësuar në një sërë komisionesh dhe strukturash vendimarrëse, përfshirë njësinë e Sigurimit të Cilësisë, grupet e vlerësimit të brendshëm dhe të tjera. GVJ sugjeron që institucioni të nxisë një angazhim më proaktiv dhe të qëndrueshëm të tyre në këto struktura vendimmarrëse. Ky angazhim mund të kontribuonte në forcimin e përfaqësimit të studentëve dhe në rritjen e ndikimit të tyre në proceset vendimmarrëse të institucioni. Gjithashtu, angazhimi më aktiv i studentëve mund të ndihmonte në identifikimin e nevojave të tyre dhe përmirësimin e proceset akademike dhe administrative.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | GVJ konstaton se KUR nëpërmjet njësive të posacme në strukturën organizative, zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e tij. Përsa më sipër është zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe sekretaria mesimore, të cilët në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë, informojnë studentët. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | GVJ konstaton se KUR ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, që kanë në përbërje të tyre, struktura në nivel institucioni siç është, zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe Alumnit si dhe sekretaria mësimore. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e institucionit, janë të sanksionuara detyrat që zyra e Këshillimit, Karrierës dhe Alumnit duhet të kryejë. GVJ konstatoi se zyra e Këshillimit, Karrierës dhe Alumnit ka zhvilluar aktivitete informimi me maturantët, sipas një kalendari paraprak, si dhe aktivitete informimi për studentët e vitit të parë.<br><br>Megjithatë, GVJ sugjeron që zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit të planifikojë dhe të organizojë aktivitete informuese dhe orientuese për studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë. Këto aktivitete duhet të fokusohet veçanërisht në mundësitë për internshipe pranë kompanive dhe për punësimin e mundshëm të studentëve pas diplomimit. GVJ sugjeron që këto aktivitete të jenë më të organizuara, të formalizuara dhe më të gjurmueshme, për t'u siguruar që studentët të kenë mundësinë për t'u orientuar në tregun e punës në mënyrë më efikase dhe të planifikuar. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ konstatoi se KUR ka krijuar Rrjetin Alumni, ku vihet re se numri i ish-studentëve të programeve të studimit bachelor në Alumni është ende i vogël. GVJ konstatoi se institucioni mban statistika të punësimit të studentëve që kanë mbaruar programet e studimit Bachelor .<br><br>*Evidenca nr. 24. Të dhëna përmbledhese për punesimin real të studentëve.pdf* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se institucioni duhet të rrisë efektivitetin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, për të siguruar një lidhje më të fortë dhe më të drejtpërdrejtë me tregun e punës. Po ashtu, duhet të mundësohet një orientim më i mirë dhe më i qëndrueshëm i studentëve, duke ofruar mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive dhe përfshirjen në aktivitete të lidhura me punësimin. Gjithashtu, GVJ sugjeron që zyra të fokusohet më shumë në gjurmimin e të dhënave për karrierën e studentëve pas diplomimit, në mënyrë që të mundësohet një mbështetje më e plotë për ata në kalimin nga studimet në tregun e punës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | GVJ, duke u mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit dhe takimet me stafin akademik dhe drejtues të programit, konstaton se KUR ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat janë të bazuara në fushën e studimeve dhe lëndët/moduleve përkatëse. Këta udhëzues janë kryesisht të fokusuar në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe mësimdhënies në distancë, dhe janë orientues për stafin akademik si dhe për studentët e programit të studimit.<br><br>*61. Google Clasroom - Manual per studentet.pdf*<br><br>*62. Manual per programin OBS per regjistrim video dhe audio..pdf*<br><br>*63. Google Clasroom - Manual per pedagogët.pdf* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë | GVJ, pas vizitës në institucion dhe takimeve me strukturat drejtuese dhe mbështetëse, konstaton se njësitë bazë përgjegjëse për programin |

| | |
|---|---|
| mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të përsonelit akademik dhe ndihmësakademik. | dhe njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kanë implementuar disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies. Këto përfshijnë kontrollin e zhvillimit të mësimit, përdorimin e pyetësorëve si mjete për vlerësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik në fusha të ndryshme. Po ashtu, përdoren pyetësorë për vlerësimin e infrastrukturës së KUR, që sigurojnë një monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ofruar nga institucioni.<br>*Evidenca nr. 48. Pyetësor që plotësohet nga studentët, për kushtet në IAL.pdf*<br>*Evidenca nr. 33. Pyetësor i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf*<br>*Evidenca nr. 32. Pyetësori i studentëve.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin përiodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetësori zhvillohet para përfundimit të çdo semestri dhe synon përfshirjen e të gjithë studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj.<br>*Evidenca nr. 48. Pyetësor që plotësohet nga studentët, për kushtet në IAL.pdf*<br>*Evidenca nr. 33. Pyetësor i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf*<br>*Evidenca nr. 32. Pyetësori i studentëve.pdf* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | GVJ konstatoi se zyra e NJSBC përgatit një raport vjetor mbi rezultatet e pyetësorëve, në të cilin analizohen gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga pyetësorët. Ky raport përmban një pasqyrë mbi cilësinë e mësimdhënies, performancën e stafit akademik, si dhe vlerësimin e infrastrukturës së ofruar nga institucioni. Pas përgatitjes, ky raport shqyrtohet nga strukturat vendimmarrëse në nivel të institucionit dhe të njësisë kryesore, për të siguruar që gjetjet të integrohen në proceset e përmirësimit të vazhdueshëm. Pjesë të këtij raporti përfshihen gjithashtu në raportin vjetor të institucionit, duke siguruar transparencë dhe një pasqyrë të qartë të përparimit dhe zhvillimeve në fushën e cilësisë, si dhe duke mundësuar një orientim të mirë për hapat e ardhshëm.<br>*Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf*<br>*88. Raporti vjetor 2022-2023 dhe shkresa percjellese ne MAS.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të | Pavarësisht se raporti publikohet në terma të përgjithshëm të gjetjeve, *GVJ sugjeron që në këto raporte të identifikohen shembujt dhe praktikat e mira, të cilat mund të shërbejnë për promovimin e kulturës* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit përsonelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | *së cilësisë brenda institucioni. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të stafit akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe të cilësisë së shërbimeve. Po ashtu, GVJ sugjeron që gjetjet kryesore të diskutohen në nivel departamenti, duke ofruar një mundësi për reflektim dhe përmirësim të brendshëm. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që rezultatet e vlerësimit për secilin pedagog të ndahen me ta në mënyrë konfidenciale, duke siguruar që informacioni të përdoret për zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe për një përmirësim të përgjithshëm të cilësisë së mësimdhënies.* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ lidhur me këtë standard, është i mendimit se Kolegji Universitar Reald, ka një politikë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Referuar strukturave të sigurimit cilësisë, rezulton se KUR, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL (sipas ligjit 802015), që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorit, përpunimin e tij dhe hartimin e raportit si dhe strukturat e njësisë bazë dhe kryesore, të cilat ndjekin monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Këto struktura funksionojnë mbi bazë të statutit dhe rregullores së KUR si dhe rregullores së NJSBC.<br><br>*Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 4. Plan pune i NJSBC.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe | GVJ konstaton se përbërja e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë është e përcaktuar qartë dhe përfshin drejtuesen e zyrës së Këshillimit të Karrierës, një përfaqësues nga çdo njësisë kryesore, një përfaqësues të studentëve dhe një ekspert të jashtëm. Kjo strukturë, e cila funksionon |

| | |
|---|---|
| zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | në përputhje me rregulloren e NJSBC, siguron një bazë të fortë për implementimin dhe monitorimin e politikave të cilësisë, duke garantuar përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit dhe një qasje të balancuar dhe gjithëpërfshirëse.<br><br>*Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 56. Urdhër i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB..pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | GVJ konstaton se KUR ka përfunduar akreditimin institucional dhe është duke i nështrohet procesit të akreditimit programor, që është edhe pjesë e procesit të vlerësimit aktual. Përveç akreditimit institucional si një formë e sigurimit të jashtëm të cilësisë, institucioni realizon një vlerësim të brendshëm të cilësisë përmes Njësisë së Sigurimit të Cilësisë.<br><br>Në raportin e cilësisë, analizohen disa indikatorë në terma sasiorë, duke u bazuar në frekuencën e përgjigjeve të studentëve për pyetjet që përmban pyetësori. Përfundimet e analizave përmbajnë rekomandime nga zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, të cilat janë identifikuar si nevoja për përmirësim. GVJ vlerëson se këto rekomandime duhet të ndiqen nga strukturat përkatëse të KUR dhe të realizohen në vazhdimësi, për të siguruar një përmirësim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të cilësisë.<br><br>*Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | GVJ, nga analiza e dosjes së vlerësimit të brendshëm dhe vizita në institucion, konstaton se përdoren disa mekanizma të monitorimit të vazhdueshëm, të tilla si monitorimi nga njësia bazë/kryesore, sondazhe të studentëve me një periodicitet dy herë në vit për vlerësimin akademik, pyetësorë për vlerësimin e infrastrukturës dhe pyetësorë për kënaqësinë e stafit, si dhe monitorimi i proceseve të mësimdhënies.<br><br>*Pavarësisht praktikave pozitive të identifikuara, GVJ sugjeron që rezultatet e pyetësorëve duhet të shpërndahen edhe individualisht për secilin pedagog. Kjo do të mundësojë diskutimin e përfitimeve dhe nevojave të përmirësimit për secilin pedagog, duke siguruar orientimin e stafit akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjes akademike.* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 4. Plan pune i NJSBC.pdf* |
| **Konkluzione** | ***GVJ konstaton se Kolegji Universitar Reald ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta dhe transparente për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", duke i përshtatur ato brenda strukturave dhe sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.***<br><br>***GVJ sugjeron që rezultatet e pyetësorëve të shpërndahen edhe individualisht për secilin pedagog. Ky veprim do të mundësojë një analizë të detajuar të performancës së secilit pedagog dhe do të ofrojë mundësi për diskutime dhe orientime për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit akademik.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br><br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve | GVJ, gjatë konsultimit të dokumenteve të depozituara në DVV, analizoi planin e punës të NJSBC dhe identifikoi disa mekanizma formale që përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e programeve të studimit. Këto përfshijnë sondazhe çdo fund semestri për vlerësimin e aspekteve të ndryshme të cilësisë, relacionet për sezonet e provimeve, kontrollin e evidencave dhe regjistrave, anketimet periodike të studentëve, si dhe analizat e zhvillimit të praktikave dhe diplomave, etj.<br><br>Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me përfaqësuesit e zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ konstaton se rezultatet e sondazheve të studentëve dokumentohen dhe analizohen në mënyrë të detajuar. Më pas, hartohet një raport përmbledhës që përmban rekomandime për të adresuar gjetjet dhe problematikat e identifikuara. Këto rekomandime ndjekin një proces të strukturuar, i cili përfshin drejtuesit e njësisë bazë, njësisë kryesore dhe strukturave të tjera të përcaktuara përkatësisht për të trajtuar çështjet në fjalë. |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Për më tepër, institucioni ka ngritur një Grup Vlerësimi të Brendshëm (GVB), që ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe ka përgatitur dosjen e vetëvlerësimit për procesin e akreditimit. Dokumentacioni i këtij procesi është referuar vazhdimisht nga GVJ gjatë shqyrtimit të procesit të vlerësimit.<br><br>*Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 4. Plan pune i NJSBC.pdf* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga përsoneli akademik dhe studentët. | Referuar RVB, GVJ konstaton se raporti i vlerësimit të brendshëm përmban një analizë të pikave të forta dhe të dobta të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Ky raport vlerëson aspektet e ndryshme të programit dhe identifikon mundësitë për përmirësim.<br><br>Po ashtu, raporti vjetor i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmban një analizë të gjetjeve kryesore të nxjerra nga sondazhet dhe vlerësimet e ndryshme, si dhe rekomandimet për adresimin e problematikave të evidentuara. Këto rekomandime rezultojne te jenë të orientuara drejt strukturave akademike dhe administrative të KUR, dhe kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe menaxhimit të programeve, si dhe rritjen e efikasitetit të funksionimit të këtyre strukturave. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | GVJ konstaton se për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", janë implementuar metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë, të cilat përfshijnë vlerësimin e mësimdhënies, didaktikës, kurrikulës dhe procesit të të mësuarit. Këto aspekte janë përfshirë në seksionet e pyetësorit që aplikohet aktualisht në sondazhet e studentëve. Ky proces i vlerësimit synon të sigurojë një pamje të qartë mbi performancën e programit dhe mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të përsonelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | GVJ konstaton se KUR për vlerësimin e cilësisë përdor sondazhe të studentëve, monitoron procesin mësimor dhe vlerëson performancën e stafit akademik. *Përveç këtyre mekanizmave, GVJ sugjeron krijimin e një Këshilli/Bordi Pune, i cili do të mundësonte përfshirjen e bizneseve lokale dhe Alumnëve në procesin e përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Ky Këshill/Bord do të mund të ofronte sugjerime dhe rekomandime për zhvillimin e aftësive dhe zotësive që studentët e diplomuar duhet të kenë për të qenë më konkurrues në tregun rajonal dhe më gjerë. Kjo do të kontribuonte në rritjen e cilësisë dhe relevancës së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".* |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se KUR monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, Bachelor në "Informatikë Ekonomike", përmes NJSBC dhe strukturave të njësisë bazë dhe kryesore, për të siguruar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të dëshiruara të të nxënit. Megjithatë, GVJ sugjeron që institucioni të përfshijë edhe stakeholders të jashtëm, si bizneset dhe Alumnët, në procesin e vlerësimit të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Ky angazhim i palëve të treta do të mundësonte përmirësimin e cilësisë dhe përshtatjen më të mirë të programit me kërkesat e tregut të punës, duke i siguruar studentëve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u bërë konkurrentë të suksesshëm në një treg global.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, përsonelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Në përbërje të njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se çdo njësi kryesore ka përfaqësues të saj. Gjithashtu, studentët përfaqësohen nga një anëtar, duke garantuar përfaqësim të gjithë aktorëve të brendshëm, staf akademik dhe studentë. Pjesë e NJSBC, është edhe një ekspert i jashtëm nga i cili institucioni mund të marrë sugjerime për përputhshmërinë e programeve të studimit me kërkesat e biznesit lokal dhe tregut të punës.<br><br>*Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 56. Urdher i Rektorit për ngritjen e Grupit te Vleresimit te Brendshem për hartimin e RVB..pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | GVJ konstatoi se të gjitha strukturat e përfshira në sigurimin e cilësisë, përfshirë NJSBC-në, njësinë kryesore, njësinë bazë dhe të tjera, kanë të sanksionuara të drejtat dhe detyrimet e tyre në Rregulloren e institucionit. Këto struktura operojnë në përputhje me akte rregullatore të miratuara, ku përcaktohen qartë procedurat, përgjegjësitë dhe detyrat e palëve të përfshira. NJSBC, si strukturë kyçe për sigurimin e cilësisë, funksionon në përputhje me rregulloren e vet të organizimit, e cila detajon mënyrën e operimit të saj dhe siguron që të gjitha aktivitetet që lidhen me vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë të realizohen në mënyrë të strukturuar dhe transparente. Kjo strukturë mbështet sigurinë që proceset e sigurimit të cilësisë janë të kontrolluara dhe monitoruara në mënyrë të vazhdueshme.<br><br>*Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf*<br><br>*Evidenca nr. 56. Urdhër i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB.pdf* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të përsonelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Konstatohet se anëtarë te njësisë kryesore janë pjesë e NJSBC përveç faktit që siç rezultoi nga vizita në institucion, anëtarët e departamentit janë pjesë edhe e grupeve të vlerësimit të brendshëm programor.<br><br>Gjithashtu studentët kanë përfaqsuesin e vet, në NJSBC si dhe në GVB.<br><br>Përfshirja e të gjitha palëve krijon mundësinë e sjelljes së këndvështrimeve të ndryshme dhe adresimin e cështjeve që janë me interes të gjerë për cilësinë e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", si për stafin akademik, studentët dhe institucionin në tërësi. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të | GVJ konstatoi se pyetësorët zhvillohen në mënyrë anonime, për të mundësuar që studentët të trajtojnë informacionin konfidencial me objektivitet të plotë. Përpunimi dhe analiza e të dhënave bëhen në terma të përgjithshëm, duke ruajtur integritetin akademik dhe duke shmangur çdo formë diskriminimi apo pabarazie ndaj personelit të |

| | |
|---|---|
| shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt përsonelit dhe studentëve. | vlerësuar dhe studentëve që kanë ofruar vlerësime. Publikimi i gjetjeve është i orientuar për të siguruar transparencë dhe drejtësi në procesin e vlerësimit. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | GVJ konstatoi se NJSBC përfshin një përfaqësues të jashtëm, si ekspert në fushën përkatëse, i cili ka një rol të rëndësishëm në vlerësimin e programeve të studimit.GVJ vlereson kete perfshirje, pasi ky përfaqësues mund të sjellë një këndvështrim të vlefshëm nga perspektiva e tregut të punës, duke ofruar një vlerësim të pavarur dhe objektiv të cilësisë së programeve dhe përshtatshmërisë së tyre me kërkesat aktuale të industrisë.<br><br>Angazhimi i një eksperti të jashtëm ndihmon në identifikimin e mundësive për përmirësim dhe në sigurinë që programet e studimit përmbushin nevojat e studentëve dhe ato të tregut të punës. Kjo mundësi përfshirje e një eksperti të jashtëm, siguron që procesi i vlerësimit të programeve të jetë më i gjithanshëm dhe që ndikimi i mundshëm i zhvillimeve të jashtme, veçanërisht ato të tregut të punës, të reflektohet në mënyrë të duhur.<br><br>*Evidenca nr. 56. Urdhër i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se KUR përfshin të gjithë aktorët e brendshëm, duke përfshirë stafin akademik, njësitë kryesore, njësitë bazë dhe NJSBC, në procesin e sigurimit të cilësisë. Ky angazhim i strukturave të ndryshme brenda institucionit siguron një koordinim të plotë dhe një vlerësim gjithëpërfshirës të proceseve akademike dhe administrative. Pjesë e këtyre strukturave janë gjithashtu përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm, të cilët kontribuojnë me këndvështrimin dhe përvojën e tyre, duke e pasuruar procesin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë. Kjo siguron një qasje të balancuar dhe objektive, duke mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe proceseve akademike të ofruara nga institucioni.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |





| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | GVJ, referuar dokumenteve të vetëvlerësimit (DVV) dhe informacionit të disponueshëm në webin zyrtar të KUR, konstaton se rregullorja e NJSBC dhe përbërja e saj, si dhe aktivitetet që zhvillohen në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë të qarta dhe transparente. Këto informacione janë të disponueshme për të gjithë palët e interesuara, duke siguruar një komunikim të hapur dhe të drejtpërdrejtë.<br><br>sigurimi i cilësisë - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)<br><br>Raporti Vjetor - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al) |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat përsonale. | GVJ konstaton se rregullorja e NJSBC, Plani i Punës i NJSBC dhe raporti vjetor janë të publikuara në faqen zyrtare të KUR. Ky transparence siguron qasje të hapur për studentët dhe palët e interesuara në informacionin e rëndësishëm mbi sigurimin e cilësisë. Po ashtu, raporti respekton standardet e lirisë dhe etikës akademike, si dhe përputhet me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar një proces të drejtë dhe të përgjegjshëm.<br><br>*Raporti Vjetor - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)*<br><br>*RREGULLORE E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (NJ.S.B.C) - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | GVJ konstaton se raporti i NJSBC përmban masat për përmirësim të mëtejshëm në nivel institucional, duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të rezultateve të anketimeve dhe të gjetjeve të tjera. *Megjithatë, GVJ sugjeron që ky raport të jetë më i detajuar dhe rekomandimet të jenë më specifike, për të mundësuar një ndërhyrje më të drejtpërdrejtë dhe të saktë në përmirësimin e proceseve.*<br><br>Gjithashtu, GVJ shqyrtoi edhe raportin vjetor të institucionit, i cili përfshin një seksion të dedikuar për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe analizën e masave të ndërmarra nga KUR për garantimin e cilësisë akademike dhe administrative.<br><br>*Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf*<br><br>*Raporti Vjetor - Kolegji Univeritar Reald (unireald.edu.al)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të | Sipas RVB, zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka një praktikë të rregullt raportimi për procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Ky raportim përfshin një analizë të vazhdueshme të rezultateve të sondazhit të studentëve dhe adreson rekomandimet që dalin nga këto gjetje. Kjo praktikë synon të sigurojë që problematikat e identifikuara të merren parasysh dhe të merren masa për përmirësimin e cilësisë në proceset mësimore dhe administrative. |

| | |
|---|---|
| cilësisë së programit të studimit. | *Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Nga takimi me strukturat drejtuese, rezulton se KUR, nëpërmjet strukturave drejtuese, njësive kryesore dhe njësisë bazë, organizon aktivitete me stafin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Kjo bëhet përmes promovimit të pjesëmarrjes në trajnime lidhur me akreditimin institucional dhe programor. Pavarësisht përpjekjeve të deritanishme, nga vizita në institucion, GVJ sugjeron që stafi dhe studentët të jenë më të sensibilizuar, informuar dhe ndërgjegjësuar për rëndësinë e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe për rolin e tyre në to, si dhe për bashkëpunimin me strukturat e tjera që janë pjesë e këtij procesi. |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se proceset dhe aktivitetet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" janë të publikuara dhe të qarta, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së programit. Megjithatë, GVJ sugjeron që stafi dhe studentët duhet të jenë më të informuar dhe të ndërgjegjësuar për rolin e tyre në këto procese, duke kuptuar rëndësinë e angazhimit të tyre për garantimin e cilësisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatike Ekonomike" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "REALD"**

**Pika të forta:**

1. Mbështetja institucionale e studentëve dhe fryma pozitive e krijuar nga departamenti jep ndikim pozitiv në mbarëvajtjen e procesit mësimor, informimit dhe shprehjen e mendimit të lirë nga studentët.
2. Infrastrukturë fizike dhe të teknologjisë së informacionit bashkëkohore.
3. Lidhje efektive me botën e biznesit premtojnë krijimin e nje network funksional për praktikat e studentëve, punësimin dhe marrjen e feebackut për përmirësimin e programit.
4. Institucioni zhvillon politika informuese në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve në programit e studimit;
5. Një program studimi i cili, në sajë të kurrikulës së ofruar, zhvillon njohuri të thelluara, aftësi e kompetenca profesionale të vlerësuara nga tregu i punës.
6. Institucioni ka struktura të duhura të cilat sigurojne një dokumentacion të programit të studimit, një sistem të regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave për studentët;

**Pika të dobta:**

1. Numri i ulët i stafit akademik me tituj dhe grada dhe ngarkesa e lartë për disa pedagogë që mbajnë edhe funksione administrative, duke krijuar nevojën për optimizimin e ngarkesës së tyre. **(Standarti III.1, kriteri 4; Standardi IV.1 / Kriteri 1, Kriteri 2);**

2. Bibliotekë me literaturë të kufizuar dhe të vjetëruar, si dhe mungesë e regjistrimeve në librari elektronike. Kërkohet azhurnimi me literaturë të përditësuar për Informatikën Ekonomike, duke reflektuar zhvillimet e shpejta të fushës. **(Standardi IV.3 / Kriteri 4);**

3. Numri i vogël i studentëve të regjistruar në programin e studimit "Informatikë Ekonomike" **(Standardi V.4 / Kriteri 5);**

4. Aktivitete të kufizuara nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, të cilat nuk janë të përshtatura plotësisht me nevojat e studentëve dhe nuk sigurojnë lidhje të forta me tregun e punës. **(Standardi VI.3 / Kriteri 3);**
5. Nevojë për informim dhe sensibilizim më të madh të stafit dhe studentëve mbi proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. **(Standardi VI.5 / Kriteri 5);**

**Rekomandime:**

1. **Zgjerimi i trupës akademike dhe optimizimi i ngarkesës mesimore**

GVJ rekomandon fuqizimin e trupës akademike përmes përfshirjes së pedagogëve me tituj dhe grada shkencore, veçanërisht në lëndët thelbësore të programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Gjithahstu, sugjerohet rishikimi dhe optimizimi i ngarkesës akademike për pedagogët që mbajnë funksione administrative, duke reduktuar numrin e orëve mësimore dhe

lëndëve të tyre. Kjo masë synon të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe efikasitetin akademik.

2. **Pasurimi I Bibliotekes dhe zgjerimi i aksesit në literaturë akademike dhe burime shkencore**

Për të mbështetur kërkimin shkencor dhe zhvillimin akademik të studentëve dhe stafit, GVJ rekomandon pasurimin e fondit të bibliotekës fizike me botime të reja dhe të përditësuara. Paralelisht, sugjerohet abonimi në biblioteka elektronike, duke ofruar akses më të gjerë në burime shkencore me ndikim të lartë professional dhe akademik.

3. **Permiresimi i aktiviteveve dhe efektivitetit te Zyres se Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit**

GVJ sugjeron që Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit të organizojë aktivitete më të strukturuara dhe të formalizuara për studentët e programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Këto aktivitete duhet të fokusohen në mundësitë e intershipeve dhe orientimin professional te studenteve, duke u përshtatur me nevojat specifike të studentëve dhe duke siguruar një mekanizëm të gjurmueshëm të ndikimit të tyre.

4. **Rritja e numrit të studentëve të regjistruar**

GVJ rekomandon që institucioni të ndërmarrë strategji aktive për të rritur numrin e studentëve të regjistruar në programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike.

5. **Përfshirja e aktorëve të jashtëm dhe forcimi i sigurimit të cilësisë**

GVJ sugjeron që institucioni të angazhojë aktorë të jashtëm, përfshirë përfaqësues nga bizneset dhe komunitetin e alumnit, në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të programit. Kjo qasje do të ndihmojë në përshtatjen e kurrikulës me kërkesat e tregut të punës. Po ashtu, rekomandohet ndërgjegjësimi i stafit akademik dhe studentëve mbi rëndësinë e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolin e tyre aktiv në këtë proces.

6. GVJ rekomandon që Departameni i Financës duhet të trajtojë ne raportet vjetore edhe problematikat në lidhje me procesin mësimor, rezultatet e studentëvë, rezultatet nga anketimet e studentëve dhe shumë element të veprimtarisë së stafi akademik në drejtim të pjesëmarrjes së tyre në konferenca apo aktivitete të tjera brenda dhe jashtë vendit
7. Literatura e detyruar dhe ndihmëse në shumicën e syllabuseve nuk është e 5-10 vite te fundit dhe për këtë GVJ rekomandon përmirësimin e saj nga ana e stafit akademik ;
8. Rregullorja e studimit duhet të reflektojë edhe format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre;

**Conclusions of the Evaluation of the First Cycle Study Program Bachelor in "Economic Informatic" offered by the Institution of Higher Education University College "REALD"**

**Strengths:**

1. The institutional support of students and the positive spirit created by the department have a positive impact on the progress of the learning process, information, and students' expression of free opinion.
2. Physical infrastructure and contemporary information technology.
3. The structure of scientific research with a vision and oriented toward quality
4. Effective connections with the business world promise the creation of a functional network for student internships, employment, and receiving feedback for program improvement.

5. The institution develops informative policies regarding the admission criteria for students in the study programs.
6. A study program that, through the curriculum offered, develops in-depth knowledge, skills, and professional competencies valued by the labor market.
7. The institution has appropriate structures in place that ensure proper documentation of the study program, as well as a system for registering and storing student data.

**Weak points:**

1. The limited number of academic staff holding titles and degrees, coupled with the significant workload of certain faculty members who also assume administrative responsibilities, highlights the need for optimizing their workload. **(Standard III.1, Criterion 4; Standard IV.1 / Criterion 1, Criterion 2).**
2. The library's collection is characterized by limited and outdated literature, along with the absence of records in the electronic library system. It is essential to update the resources in Economic Informatics to reflect the rapid advancements in the field. **(Standard IV.3 / Criterion 4).**
3. The small number of students enrolled in the "Economic Informatics" program remains a concern. **(Standard V.4 / Criterion 5).**
4. Activities offered by the Career Counseling and Alumni Office are currently limited and do not fully address the needs of students, nor do they foster strong connections with the labor market. **(Standard VI.3 / Criterion 3).**
5. There is a clear need for increased awareness and sensitization among both staff and students regarding internal quality assurance processes. **(Standard VI.5 / Criterion 5).**

**Recommendations:**

1. **Expansion of the Academic Staff and Optimization of Teaching Load**

EEG recommends strengthening the academic staff by involving in program study academic staff with academic titles and degrees, particularly for core subjects in the Bachelor's program in "Economic Informatics." Additionally, it is suggested to review and optimize the academic load of academic staff of the program holding administrative positions by reducing their teaching hours and number of courses. This measure aims to improve the quality of teaching and academic efficiency.

2. **Enrichment of the Library and Expansion of Access to Academic Literature and Scientific Resources.**

To support scientific research and the academic development of students and staff, EEG recommends enriching the physical library's collection with new and updated publications. At the same time, it is suggested to subscribe to electronic libraries, providing broader access to high-impact scientific resources for both professional and academic growth.

3. **Improvement of Activities and Effectiveness of the Career Counseling and Alumni Office**

EEG suggests that the Career Counseling and Alumni Office organize more structured and formal activities for students in the Bachelor's program in "Economic Informatics." These

activities should focus on internship opportunities and professional guidance for students, tailored to the specific needs of the students and ensuring a traceable mechanism to assess their impact.

4. **Increase in the Number of Enrolled Students**
   EEG recommends that the institution adopt active strategies to increase the number of students enrolled in the bachelor's program in "Economic Informatics.";

5. **Involvement of External Actors and Strengthening of Quality Assurance**
   EEG suggests that the institution engage external actors, including representatives from businesses and the alumni community, in the process of evaluating and improving the program. This approach will help align the curriculum with labor market demands. Furthermore, it is recommended to raise awareness among academic staff and students regarding the importance of internal quality assurance processes and their active role in this process.

6. The EEG recommends that the Department of Finance should address, in the annual reports, issues related to the teaching process, student performance, results from student surveys, and various aspects of academic staff activities, particularly regarding their participation in conferences or other events both domestically and internationally.
7. The required and supplementary literature in the majority of syllabi is outdated, with most texts not being from the last 5 to 10 years. Therefore, the EEG recommends that academic staff update the literature accordingly.

8. The EEG recommends that the study regulations should also reflect the formats of knowledge assessment and their evaluation.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |